

**STATUTI**  
**I UNIVERSITETIT TË EVROPËS JUGLINDORE**

**TETOVË, mars 2019**

## PËRMBAJTJA

<b>STATUTI I UNIVERSITETIT TË EVROPËS JUGLINDORE .....</b>	<b>4</b>
<b>I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME .....</b>	<b>4</b>
<i>Objekt i rregullimit .....</i>	4
<i>Pozita e Universitetit.....</i>	4
<i>Emri dhe selia e Universitetit .....</i>	5
<i>Vula, simbolet dhe veçoritë e tjera të Universitetit .....</i>	5
<i>Misioni i Universitetit.....</i>	6
<i>Bashkësia akademike dhe kodi etik .....</i>	7
<b>II. AUTONOMIA E UNIVERSITETIT .....</b>	<b>7</b>
<i>Përmbajtja dhe mbrojtja e autonomisë .....</i>	7
<i>Llogaridhënia dhe përgjegjësia e Universitetit .....</i>	9
<i>Mbrojtja e autonomisë .....</i>	9
<i>Zgjidhja paqësore e kontesteve .....</i>	9
<i>Promovimi i punës së Universitetit dhe informimi i publikut .....</i>	10
<b>III. STATUSI I PERSONIT JURIDIK DHE PËRBËRJA E UNIVERSITETIT.....</b>	<b>10</b>
<i>Statusi i Universitetit.....</i>	10
<i>Përbërja e Universitetit .....</i>	11
<i>Fakultetet.....</i>	11
<i>Institutet shkencore .....</i>	11
<i>Organizimi i brendshëm i njësive të Universitetit .....</i>	11
<i>Njësitë e brendshme organizative të Universitetit.....</i>	12
<i>Autorizimet e njësive të Universitetit.....</i>	12
<i>Autorizimet e njësive të brendshme organizative të Universitetit.....</i>	12
<i>Ndryshimet statusore të Universitetit.....</i>	13
<b>IV. ORGANET DHE TRUPAT E UNIVERSITETIT .....</b>	<b>13</b>
<i>Bordi i Universitetit .....</i>	13
<i>Kompetencat e Bordit të Universitetit .....</i>	16
<i>Senati i Universitetit.....</i>	17
<i>Kompetencat e Senatit të Universitetit.....</i>	18
<i>Kryetari i Senatit .....</i>	20
<i>Rektori dhe Prorektorët .....</i>	21
<i>Kompetencat e Rektorit.....</i>	22
<i>Prorektorët.....</i>	23
<i>Drejtoria e Rektoriale.....</i>	24
<i>Kompetencat e Drejtorisë Rektoriale.....</i>	24
<i>Mënyra e punës së Drejtorisë Rektoriale .....</i>	25
<i>Sekretari i përgjithshëm dhe Shërbimet administrative dhe profesionale.....</i>	26
<i>Shërbimet profesionale dhe administrative.....</i>	26
<i>Personi i autorizuar për pranimin e fletëparaqitjeve për korrupsion.....</i>	27
<i>Organet dhe trupat e njësive të Universitetit .....</i>	27
<i>Organet e fakultetit .....</i>	27
<i>Këshilli mësimor – shkencor.....</i>	27
<i>Kompetencat e këshillit mësimor – shkencor.....</i>	28
<i>Këshilli shkencor i Institutit .....</i>	28
<i>Dekani i fakultetit dhe kompetencat e tij .....</i>	29
<i>Drejtoria e dekanatit.....</i>	30
<i>Këshilli për bashkëpunim dhe besim me publikun .....</i>	31
<i>(Ekipet e cilësisë).....</i>	31
<b>V. VEPRIMTARIA E UNIVERSITETIT DHE NJËSIVE .....</b>	<b>31</b>
<i>Veprimtaria e Universitetit .....</i>	31
<i>Veprimtaria e njësive të Universitetit .....</i>	33
<i>Fakultetet.....</i>	33
<i>Instituti shkencor si ushtrues i veprimtarisë së arsimit të lartë .....</i>	34
<b>VI. STUDENTËT DHE ORGANIZATAT E STUDENTËVE.....</b>	<b>34</b>

<i>Statusi i studentit</i> .....	34
<i>Të drejtat dhe detyrimet e studentëve</i> .....	35
<i>Rregullat e studimit</i> .....	36
<i>Ndërprerja e statusit të studentit</i> .....	36
<i>Përgjegjësia disiplinore e studentëve</i> .....	36
<i>Llojet e shkeljeve disiplinore</i> .....	37
<i>Llojet e masave disiplinore</i> .....	37
<i>Avokati i studentëve</i> .....	38
<i>Organizimi dhe pjesëmarrja e studentëve në qeverisje</i> .....	38
<i>Organizimi studentor</i> .....	38
<i>Pjesëmarrja e studentëve në qeverisje</i> .....	39
<i>Alumni i studentëve</i> .....	39
VII. FINANCIMI DHE PASURIA E UNIVERSITETIT .....	40
<i>Parimet bazike të menaxhimit financiar</i> .....	40
<i>Burimet e financimit të Universitetit</i> .....	40
<i>Mjetet (Asetet) e Universitetit</i> .....	42
VIII. VEPRIMTARIA E ARSIMIT TË LARTË .....	42
<i>Ciklet e arsimit të lartë</i> .....	42
<i>Cikli i parë i studimeve akademike-studime deridiplomike</i> .....	42
<i>Cikli i dytë i studimeve - studime pasdiplomike</i> .....	43
<i>Cikli i dytë i studimeve akademike (studime pasdiplomike)</i> .....	43
<i>Ciklit i dytë i studimeve profesionale</i> .....	43
<i>Cikli i tretë i studimeve universitare - Studimet e doktoratës</i> .....	44
IX. PROGRAMET STUDIMORE.....	45
<i>Përmbajtja e programeve studimore</i> .....	45
<i>Programe për përsosje të specializuar dhe profesionale</i> .....	46
<i>Program studimor për diplomë të përbashkët</i> .....	47
<i>Transferi i kredive</i> .....	47
<i>Mënyra e regjistrimit të studimeve</i> .....	47
<i>Promovimi i personave që kanë përfunduar programet e ciklit të tretë në studimet akademike - studimet e doktoratës dhe kanë marrë titullin shkencor Doktor i Shkencave</i> .....	48
X. THIRRJET MËSIMORE - SHKENCORE, MËSIMORE – PROFESIONALE, MËSIMORE, SHKENCORE DHE THIRRJET PËR BASHKËPUNËTORËT .....	48
<i>Llojet e thirrjeve</i> .....	49
<i>Neni 98</i> .....	49
<i>Demonstratorët</i> .....	49
<i>Kriteret dhe kushtet për zgjedhje në thirrje</i> .....	50
<i>Afatet për të cilat bëhet zgjedhja</i> .....	50
<i>Themelimi i marrëdhënies së punës</i> .....	50
<i>E drejta për të ushtruar veprimtari në institucion tjetër të arsimit të lartë</i> .....	51
<i>Mësimdhënës vizitorë</i> .....	51
<i>Shkencëtarët, artistët dhe ekspertët e afirmuar nga praktika</i> .....	52
<i>Thirrjet e titulluara</i> .....	52
<i>Profesor nderi dhe doktor shkence i nderit</i> .....	53
<i>Profesor emeritus</i> .....	53
<i>Pushimi sabatik (sabbatical)</i> .....	53
<i>Diplomat</i> .....	54
<i>Tituj e profesional dhe shkencor</i> .....	54
XI. VETËVLERËSIMI .....	54
XII BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.....	55
XIII DOKUMENTACIONI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE .....	55
XIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE .....	57

Në bazë të nenit 9, paragrafi 1, alineja 2 dhe 3, nenit 16 dhe nenit 92, paragrafi 3 të Ligjit për arsim të lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut “Gazeta Zyrtare”, numër 82/2018, Bordi i Universitetit të Evropës Juglindore, më 15.03.2019 sollii këtë:

## **STATUT TË UNIVERSITETIT TË EVROPËS JUGLINDORE**

### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Objekt i rregullimit**

##### **Neni 1**

Me këtë Statut përcaktohen dhe rregullohen: statusi, misioni dhe udhëheqja e Universitetit të Evropës Juglindore - UEJL (në tekstin e mëtejshëm: Universiteti); realizimi i autonomisë së Universitetit; organizimi, kompetencat dhe mënyra e vendosjes së organeve dhe trupave të Universitetit; statusi, organizimi dhe veprimtaria e njësive në përbërjen e tij; statusi, organizimi dhe qeverisja e studentëve; avokati studentor; realizimi i studimeve; financimi dhe pasuria e Universitetit; programet studimore; thirrjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore dhe thirrjet e tjera të mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve dhe të punësuarve të tjerë; hulumtimi shkencor; sigurimi i cilësisë; bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, si dhe çështjet tjera me rëndësi për realizimin e veprimtarisë së Universitetit.

#### **Pozita e Universitetit**

##### **Neni 2**

- (1) Universiteti i Evropës Juglindore është institucion i pavarur i arsimit të lartë privat-publik jofitimprurës, i cili realizon interes publik.
- (2) Universiteti përbëhet nga fakultetet dhe institutet, si njësi të Universitetit me të drejta dhe detyra të përcaktuara me Ligj.

- (3) Universiteti është anëtar i Konferencës Ndëruniversitare dhe asociacioneve të tjera nga veprimtaria e arsimit të lartë.

### **Emri dhe selia e Universitetit**

#### **Neni 3**

- (1) Emri i Universitetit në gjuhën shqipe është “Universiteti i Evropës Juglindore”, ose në formën e shkurtuar si “Universiteti i EJL”.
- (2) Emri i Universitetit në gjuhën angleze është “South East European University”, ose në formën e shkurtuar si “SEE University”.
- (3) Emri i Universitetit në gjuhën maqedonase është „Универзитет на Југоисточна Европа“, ose në formën e shkurtuar si „Универзитет на ЈИЕ“.
- (4) Emri ceremonial i Universitetit në gjuhën latine është “Universitas Europae Orientalis Meridionalis”
- (5) Selia e Universitetit është në: Bul. Ilindenska nr. 335, 1200 Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut; бул.Илинденска бр. 335, 1200 Тетово, Република Северна Македонија; Blvd. Ilindenska no. 335 1200 Tetovo, Republic of North Macedonia.

### **Vula, simbolet dhe veçoritë e tjera të Universitetit**

#### **Neni 4**

- (1) Universiteti e ka vulën e vet.
1. Vula e përmban emrin dhe selinë e Universitetit.
  2. Vula e Universitetit e përmban emrin Republika e Maqedonisë së Veriut.
  3. Në mes të vulës së Universitetit është simboli trekëndor i Universitetit.
  4. Universiteti ka dy vula:
    - 4.1.Vulën e thatë me formë të rrumbullakët, në mes me simbolin trekëndor të Universitetit dhe me mbishkrimin e emrit të Universitetit në latinisht:*Universitas Europae Orientalis Meridionalis*. Kjo vulë përdoret për dhënien e diplomave për shkallën e përgatitjes profesionale.
    - 4.2.Vulën në formë të rrumbullakët, në mes me simbolin trekëndor të Universitetit dhe mbishkrim në dy rreshta në tri gjuhë (shqip,

maqedonisht dhe anglisht) ku në rreshtin e brendshëm është emri i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe rreshtin e jashtëm janë emri dhe selia e Universitetit. Kjo vulë përdoret për punën arkivore në Universitet.

(2) Simbol i Universitetit është flamuri i Universitetit.

1. Flamuri i Universitetit është i bardhë me formë drejtkëndëshi, ku në mes të flamurit është simboli i Universitetit i rrethuar me emrin e Universitetit në latinisht, pasuar nga emri i Universitetit në të tri gjuhët (shqipe, maqedonase dhe angleze).

(3) Gjerdani (*insignia*) e rektorit është në formë tetëkëndore dhe në mes të shenjave e ka simbolin trekëndor të Universitetit të rrethuar me emrin e Universitetit në latinisht.

(4) Vulën, simbolet dhe veçoritë tjera të Universitetit caktohen nga Bordi me propozim të Senatit.

(5) Njësitë e Universitetit kanë të drejtë ta përdorin emrin, simbolin dhe flamurin e Universitetit në mënyrën e përcaktuar me këtë Statut.

(6) Dita e përvjetorit të Universitetit është data 19 nëntor (dita kur është themeluar UEJL).

## **Misioni i Universitetit**

### **Neni 5**

(1) Universiteti ka për mision që:

1. Të organizojë studime sipas programeve studimore të akredituara në një perspektivë të gjerë evropiane dhe ndërkombëtare.
2. Të veprojnë në përputhje me angazhimin për të arritur përsosmëri në veprimtarinë mësimore-hulumtuese.
3. Të jetë i hapur për të gjithë, në baza të paanësisë dhe meritës.
4. Të mbrojtë autonominë e Universitetit dhe lirinë akademike.
5. Të bashkëpunojë në mënyrë aktive me universitetet tjera në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por edhe me universitetet e tjera në Evropë e më gjerë.

6. Të kontribuojë për arsimin e lartë në gjuhën shqipe.
7. Të promovojë mirëkuptimin ndëretnik.
8. Të krijojë mundësinë që çdo individ nën kushte të barabarta të fitojë arsimin e lartë dhe të arsimohet përgjatë gjithë jetës.
9. Të sigurojë qasje shumë-gjuhësore dhe shumë-kulturore ndaj mësimdhënies dhe hulumtimit.
10. Të zhvillojë përgjegjësinë qytetare dhe akademike në shoqëri.

### **Bashkësia akademike dhe kodi etik**

#### **Neni 6**

- (1) Bashkësinë akademike e përbëjnë personat e zgjedhur në thirrje mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore dhe bashkëpunëtori dhe studentët.
  1. Profesorët e rregullt mbeten anëtarë të bashkësisë akademike edhe pas pensionimit të tyre.
- (2) Anëtarët e bashkësisë akademike të Universitetit janë të obliguar që të zbatojnë Kodin etik të Universitetit.

## **II. AUTONOMIA E UNIVERSITETIT**

### **Përmbajtja dhe mbrojtja e autonomisë**

#### **Neni 7**

- (1) Universiteti, njësitë dhe bashkësia akademike gëzojnë autonomi, në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare jashtë çdo lloji ndikimi politik ose ndikimi tjetër të jashtëm sa i takon veprimtarisë së tyre.
- (2) Autonomia e Universitetit përfshin përgjegjësinë e anëtarëve të bashkësisë akademike ndaj bashkësisë shoqërore, në të cilin veprojnë.
- (3) Autonomia e Universitetit përfshin: lirinë akademike, autonominë në qeverisje, autonominë financiare, autonominë kadrovike, pacenueshmërinë e hapësirës së universitetit dhe paprekshmërinë e autonomisë.

1. Liria akademike përfshin lirinë e organizimit dhe shprehjes së anëtarëve të bashkësisë akademike; lirinë e punës shkencore-hulumtuese; pavarësinë e organizimit të brendshëm; lirinë e mësimdhënies, zbatimit të hulumtimeve shkencore dhe publikimit; zgjedhjen e programeve studimore dhe interpretimit të tyre; përcaktimit të kushteve për studime në tre cikle të studimit; ndarjen e thirrjeve mësimore-shkencore, shkencore, profesionale, etj.
2. Autonomia në qeverisje shprehet në: planifikimin, realizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së arsimit të lartë; vendosjen dhe rregullimin e organizimit të brendshëm; sjelljen e Statutit dhe akteve tjera të përgjithshme dhe çështje të tjera të përcaktuara me Ligj.
3. Autonomia financiare përfshin disponimin në mënyrë të pavarur me fondet e marra nga pagesa e taksës shkollore dhe participimi i studentëve, donacionet, si dhe burimet e tjera me qëllim të kryerjes së veprimtarisë shkencore-hulumtuese, botuese dhe aplikative. Universiteti në mënyrë të pavarur vendos për akumulimin e mjeteve financiare.
4. Autonomia kadrovike përfshin autonominë e sjelljes së vendimit për nevojën për punësim, ose angazhim të personave me thirrje mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe thirrje bashkëpunëtori, përzgjedhjes së personave dhe përcaktimit të kushteve për punësim dhe angazhim në pajtim me Ligjin, Statutin dhe rregulloret.
5. Pacenueshmëria e hapësirës së Universitetit nënkupton që policia dhe organet tjera të sigurisë shtetërore nuk mundet që pa pëlqimin e rektorit, dekanit, drejtorit, ose të personit të autorizuar prej tyre, të hyjnë në këtë hapësirë, përveç për pengim të kryerjes së veprës penale që pritet të ndodhë, ose të veprës penale që ka filluar, për ndalimin e kryerësit të saj, si dhe në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.
6. Paprekshmëria e autonomisë së Universitetit nënkupton që autonomia e Universitetit nuk mund të shkelet me:
  - 6.1. pjesëmarrje të paftuar në veprimtarinë e Universitetit, dhe



6.2.kryerje të veprimtarisë së arsimit të lartë dhe veprimtarisë tjetër, e cila i rrezikon të drejtat e anëtarëve të bashkësisë akademike të orientuara drejt diskriminimit të personit dhe qytetarit, të lidhura me gjininë, orientimin seksual, racën, ngjyrën e lëkurës, prejardhjen kombëtare dhe etnike, origjinën sociale, bindjet politike dhe fetare dhe përkatësinë, moshën, pronën dhe gjendjen shoqërore;

- (4) Ndalohet organizimi dhe veprimi partiak si dhe përdorimi i simboleve partiake në Universitet.
- (5) Autonomia nuk guxon të interpretohet në mënyrën që do të shkelte të drejtat e njeriut.

### **Llogaridhënia dhe përgjegjësia e Universitetit**

#### **Neni 8**

(1) Llogaridhënia dhe përgjegjësia e Universitetit shprehet nëpërmjet:

1. Parashtrimin të raportit vjetor për punë në kuadër të bashkësisë universitare dhe publikut të gjerë.
2. Parashtrimin të raportit për punën financiare.
3. Krijimin të sistemit të brendshëm për vlerësim të efektivitetit, efikasitetit dhe cilësisë së veprimtarisë së Universitetit sipas sistemit të metrikës përkatëse.
4. Realizimin të vlerësimit dhe vetëvlerësimit në pajtim me Ligjin dhe aktet e Universitetit.

### **Mbrojtja e autonomisë**

#### **Neni 9**

- (1) Autonomia e Universitetit gëzon mbrojtje gjyqësore.
- (2) Në raste të cenimit të autonomisë, Universiteti ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore para gjykatës kompetente.

### **Zgjidhja paqësore e kontesteve**

#### **Neni 10**

- (1) Kontestet ndërmjet anëtarëve të bashkësisë akademike të Universitetit dhe kontestet ndërmjet njësive zgjidhen me marrëveshje, në organet e përbashkëta dhe në një mënyrë tjetër të mirëkuptimit në përputhje me këtë Statut dhe rregulloret.
- (2) Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në Universitet formohet Komision.
- (3) Raporti i Komisionit i dorëzohet Rektorit, i cili vepron sipas tij.
- (4) Gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, aktiviteti i rregullt i Universitetit nuk mund të pengohet.

### **Promovimi i punës së Universitetit dhe informimi i publikut**

#### **Neni 11**

- (1) Puna e Universitetit është publike.
- (2) Mbledhjet e organeve të Universitetit janë publike.
- (3) Në rastet kur në mbledhjet e organeve diskutohet për çështje që paraqesin sekret, me vendim të organit mund të përjashtohet publiku.
- (4) Për punën e vet, vendimet si dhe veprimtarinë e vet Universiteti e informon publikun nëpërmjet shtypit ditor, radios, televizorit dhe medimeve të tjera.
- (5) Universiteti ka këto mjete të informimit publik:
  1. Ueb faqen e Universitetit, ku shpallen Statuti dhe aktet etjera të përgjithshme të Universitetit, Aktvendimet për akreditim të programeve studimore, etj.
  2. Buletinin e Universitetit.

### **III. STATUSI I PERSONIT JURIDIK DHE PËRBËRJA E UNIVERSITETIT**

#### **Statusi i Universitetit**

#### **Neni 12**

- (1) Universiteti ka statusin e personit juridik me të gjitha të drejtat dhe detyrat e përcaktuara me Ligj dhe këtë Statut.
- (2) Në qarkullimin juridik me persona të tretë Universiteti vepron në emër dhe llogari të vet.
- (3) Universiteti ka llogaritë e veta nga të cilat realizon detyrimet në qarkullimin juridik.

(4) Njësitë e Universitetit nuk kanë statusin e personit juridik.

### **Përbërja e Universitetit**

#### **Neni 13**

- (1) Universiteti përbëhet nga njësitë, siç janë: fakultetet, institutet shkencore dhe njësitë e tjera.
- (2) Universiteti, nën kushte të përcaktuara me Ligj mund të themelojë shoqëri tregtare dhe subjekte të tjera.

### **Fakultetet**

#### **Neni 14**

Fakultetet në vijim janë pjesë e Universitetit:

1. Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë
2. Fakulteti i Drejtësisë
3. Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit
4. Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore
5. Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore

### **Institutet shkencore**

#### **Neni 15**

Institucionet shkencore në vijim janë pjesë e Universitetit:

1. Instituti Shkencor “Maks van der Shtul”
2. Instituti i Mjedisit Jetësor dhe i Shëndetit
3. Instituti për Hulumtime të Aplikuara në Biznes dhe Shkenca Kompjuterike.

### **Organizimi i brendshëm i njësive të Universitetit**

#### **Neni 16**

Njësitë e Universitetit për realizimin e aktivitetit të tyre mund të organizohen në: departamente, katedra dhe qendra.

## **Njësitë e brendshme organizative të Universitetit**

### **Neni 17**

- (1) Njësi të tjera të brendshme organizative mund të themelohen në kuadër të Universitetit: institute, sektor, qendra, biblioteka, parqe teknologjike, qendra për këshilla ligjore dhe biznesi, klinika ligjore, qendra për punë sociale dhe ndihma të tjera për qytetarët.
- (2) Aktin e themelit e sjell Bordi i Universitetit me propozim të Senatit në përputhje me këtë Statut.
- (3) Bashkë me vendimin duhet të sigurohen:
  1. elaborati për themelim;
  2. asetet e punës;
  3. plani dhe programi i punës;
  4. objekti, pajisjet dhe hapësira;
  5. numri i kërkuar i punëtorëve;
  6. kushte tjera.

## **Autorizimet e njësive të Universitetit**

### **Neni 18**

- (1) Njësitë e Universitetit kanë të drejta dhe detyrime të përcaktuara me Ligjin dhe këtë Statut.
- (2) Fakultetet, institutet, qendrat dhe njësitë tjera në Universitet nuk kanë status të personit juridik dhe nuk mund të posedojnë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të drejta nga pronësia intelektuale dhe as llogari të tyre.
- (3) Universiteti zhvillon aktivitetin e prokurimit për të gjitha njësitë akademike dhe njësitë tjera organizative.
- (4) Njësitë e Universitetit në qarkullimin juridik veprojnë me simbolet e Universitetit në pajtim me Ligjin dhe këtë Statut.

## **Autorizimet e njësive të brendshme organizative të Universitetit**

### **Neni 19**

Njësitë e brendshme organizative të Universitetit mund të kenë të drejta të caktuara në qarkullimin juridik në vëllim dhe nën kushte të caktuara me aktin e themelimit dhe me rregullore.

### **Ndryshimet statusore të Universitetit**

#### **Neni 20**

- (1) Universiteti mund të ngjitet, të ndahet ose të bashkohet sipas kushteve dhe procedurës të përcaktuar me Ligjin për arsim të lartë, Ligjin për Institucionet dhe këtë Statut .
- (2) Ndryshime statusore mund të realizohen edhe për njësitë në kuadër të Universitetit, respektivisht, ata mund të shkrihen, të ndahen dhe të bashkohen.

### **IV. ORGANET DHE TRUPAT E UNIVERSITETIT**

#### **Neni 21**

Organet kryesore të Universitetit janë: Bordi i Universitetit, Senati, Rektori dhe Drejtoria Rektoriale.

#### **Bordi i Universitetit**

#### **Neni 22**

- (1) Bordi i Universitetit është organ kolektiv qeverisës i Universitetit.
- (2) Bordi ka përgjegjësi për funksionimin institucional të Universitetit, si dhe është përgjegjës për strategjinë, politikat strategjike dhe të gjitha vendimet në lidhje me çështjet financiare në mënyrë që të sigurojë kushte të qëndrueshme për funksionimin normal të Universitetit.
- (3) Bordi përgatit raport vjetor dhe të njëjtin e shpall në ueb faqen e Universitetit.
- (4) Anëtarët e Bordit të Universitetit zgjidhen nga Bordi në momentin e përfundimit të mandatit të anëtarëve të mëparshëm. Në raste të veçanta të ndërprerjes së parakohshme të mandatit të anëtarit, Bordi mund të zgjedhë një anëtar të ri. Mandati i anëtarit të ri zgjat deri në mbarimin e afatit të anëtarit të mëparshëm.
- (5) Bordi përbëhet nga shtatë anëtarë, prej të cilëve:

1. Dy anëtarë ndërkombëtarë, të cilët mund të emërohen në konsultim me misionet diplomatike të BE-së dhe Shteteve të Bashkuara (nga shoqatat, ose institucionet përkatëse akademike);
2. Tre anëtarë, shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pjesëtarë të stafit të Universitetit me orar të plotë pune, të zgjedhur nga Senati.
3. Dy anëtarë të bashkësisë shoqërore, të cilët nuk janë pjesë e stafit të Universitetit, të përzgjedhur përmes konkursit nga të cilët njëri është nga komuniteti i biznesit dhe ka kontribut të dëshmuar konkret në arsimin e lartë dhe shkencën, kurse i dyti është nga asociacionet, ose bashkësia akademike e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nuk ka konflikt interesi.
4. Në rast të një interesi të rëndësishëm nga Qeveria, përkatësisht nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, të cilët marrin pjesë në bashkëfinancimin e Universitetit, një nga dy anëtarët nga alinea 3, paragrafi 5 të këtij neni emërohet nga ata.

### **Neni 23**

- (1) Bordi ka kryetar dhe nënkryetar.
- (2) Kryetari dhe nënkryetari i Bordit zgjidhen nga Bordi i Universitetit nga anëtarët e tij në mënyrë të përcaktuar me Rregulloren për punën e Bordit.
- (3) Kryetari i Bordit udhëheq me Bordin e Universitetit.
- (4) Në rast të mungesës së kryetarit, me Bordin e Universitetit udhëheq nënkryetari i Bordit.
- (5) Kryetari i Bordit të Universitetit posedon edhe të drejtën e votës shtesë. Vota shtesë është funksionale në rast të numrit të barabartë të votave nga anëtarët e Bordit.
- (6) Anëtarët e Bordit të Universitetit, shtetas të huaj, mund të marrin pjesë në aktivitetet e Bordit edhe në forma tjera që nuk përfshijnë pjesëmarrjen fizike, gjë që përshkruhet me një rregull të sjellë nga vetë Bordi i Universitetit.
- (7) Rektori i Universitetit merr pjesë në punën e Bordit, pa të drejtë vote.

### **Neni 24**

- (1) Çdo anëtar i Bordit të Universitetit ka mandat katërvjeçar, me të drejtë edhe në një zgjedhje, me kusht që nuk mund të zgjidhet, ose rizgjidhet personi që ka mbushur moshën 70 vjet.
- (2) Mandati i kryetarit dhe nënkryetarit korrespondojnë me atë të anëtarësisë së tyre në Bordin e Universitetit, ose mbaron me vdekjen, dorëheqjen ose shkarkimin e tyre nga detyra, ashtu siç përcaktohet në paragrafin (3) të këtij neni.
- (3) Mandati i anëtarit të Bordit mund të ndërpritet me shkarkim në rast se:
  1. Është dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg mbi gjashtë muaj.
  2. Manifeston sjellje diskredituese për Universitetin.
  3. Dëshmon paaftësi për të kryer funksionin, si pasojë e mungesës së kapacitetit fizik, apo mental, të vërtetuar me certifikatë mjekësore.
  4. Dështon, refuzon apo neglizhon në mënyrë të vazhdueshme ose shpreh paaftësi për të kryer detyrat e postit.

## **Neni 25**

- (1) Bordi i Universitetit, në përputhje me këtë Statut, themelon trupa të veta ndihmëse në formë të komiteteve dhe komisioneve për detyra të veçanta.
- (2) Bordi i Universitetit zgjedh Komitetin ekzekutiv, Komitetin për Auditim dhe Menaxhim të Rrezikut etj.
  1. Komiteti Ekzekutiv përbëhet nga:
    - Kryetari i Bordit të Universitetit, i cili udhëheqë me të;
    - Nënkryetari i Bordit të Universitetit;
    - Një prej anëtarëve të Bordit, të zgjedhur nga vetë Bordi.
  - 1.1. Mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv mund të thirren nga:
    - Kryetari i Bordit të Universitetit;
    - Rektori;
    - Shumica e anëtarëve të Bordit të Universitetit.

- 1.2. Bordin i Universitetit në kuadër të kompetencave të veta përcakton të drejta dhe detyra për Komitetin Ekzekutiv të përcaktuara në Rregulloren e punës së Bordit.
  - 1.3. Komiteti Ekzekutiv i raporton Bordit të Universitetit për punën e tij.
  - 1.4. Cilido anëtar i Komitetit Ekzekutiv, shtetas i huaj, mund të marrë pjesë në aktivitetet e komitetit edhe në forma tjera që nuk përfshijnë pjesëmarrjen fizike, që përshkruhet në Rregulloren e punës së Bordit.
2. Komiteti për Auditim dhe Menaxhim të Rrezikut përbëhet nga:
- Kryetar i Bordit të Universitetit;
  - Një anëtar i Bordit nga komuniteti i biznesit;
  - Një anëtar i Bordit nga Senati i Universitetit.
- 2.1 Komiteti për Auditim dhe Menaxhim të Rrezikut i rekomandon Bordit të Universitetit caktimin e revizorëve të pavarur të jashtëm, që do ta realizojnë auditimin vjetor të pasqyrave financiare.
- 2.2 Revizorët do të dorëzojnë raport, nëse kjo u kërkohet nga Bordin i Universitetit, ose Komiteti për Auditim dhe Menaxhim të Rrezikut.
- 2.3 Organizimi dhe funksionimi i Komitetit për auditim dhe menaxhim të rrezikut rregullohet me Rregulloren e punës së Bordit të Universitetit.

## **Neni 26**

Sekretari i përgjithshëm i Universitetit do të jetë njëkohësisht edhe sekretar i Bordit dhe i Komitetit Ekzekutiv.

## **Kompetencat e Bordit të Universitetit**

### **Neni 27**

(1) Kompetencat e Bordit të Universitetit janë:

1. Të përcaktojë misionin e Universitetit me propozim të Senatit dhe të kujdeset për realizimin e tij;
2. Të draftojë dhe miratojë strategjinë për zhvillimin e Universitetit;
3. Të miratojë buxhetin dhe llogarinë vjetore, të propozuara nga Rektori dhe të shqyrtuara nga Senati në përputhje me Statutin;



4. Të mbikëqyrë dhe merr masa për të siguruar shfrytëzimin efektiv të burimeve, mbrojtjen e pasurisë së Universitetit, duke përfshirë edhe strategjinë për menaxhim të rrezikut;
5. Të vendosë për formën dhe përmbajtjen e flamurit, stemës dhe diplomës në pajtueshmëri me ligjet në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
6. Të sjellë rregullore për menaxhimin e Universitetit;
7. Si dhe punë tjera të përcaktuara me Ligjin dhe Statutin.

#### **Neni 28**

- (1) Vendimet e Bordit të Universitetit sillen me shumicë të thjeshtë të votave.
- (2) Në rastet kur vendimi ka të bëjë me: sjelljen dhe ndryshimin e Statutit; mbylljen e Universitetit, ndryshimet statusore (ngjitja, bashkimi apo ndarja e Universitetit); zgjedhjen, suspendimin, apo shkarkimin e Rektorit, si dhe çështje të tjera të përcaktuara nga vetë Bordi, vendimi sillet me shumicë prej dy të tretave të votave të anëtarëve të Bordit, me atë që vendimi do të konsiderohet i sjellur në qoftë se ka votuar një anëtar ndërkombëtar i Bordit.

#### **Neni 29**

- (1) Procedurat për mbajtjen e mbledhjeve të Bordit të Universitetit caktohen nga vetë Bordi në koordinim me Sekretarin e përgjithshëm.
- (2) Bordi i Universitetit dhe Komiteti Ekzekutiv, Kryetarit të Bordit të Universitetit, mund t'i delegojnë detyra, dhe t'i revokojnë të njëjtat, në qoftë se kjo është në dobi të Universitetit.
- (3) Thirrja e mbledhjeve dhe puna e Bordit të Universitetit rregullohen me Rregulloren e Punës së Bordit.

### **Senati i Universitetit**

#### **Neni 30**

Senati i Universitetit është organ profesional i cili përbëhet nga:

1. Rektori;
2. Prorektorët;
3. Dekanët e fakulteteve dhe drejtorët e njësive tjera akademike;

4. Dy anëtarë të zgjedhur nga stafi akademik i çdo fakulteti të zgjedhur me votim nga këshilli mësimorë-shkencor të fakultetit.
  5. Përfaqësues të studentëve të zgjedhur nga Parlamenti studentor (së paku 10%, por, jo më shumë se 15% nga numri i përgjithshëm anëtarëve të Senatit);
  6. Një anëtar i zgjedhur nga ana e stafit jo - akademik.
- (1) Mandati i anëtarëve të senatit zgjat tre vjet me të drejtë edhe në një zgjedhje.
  - (2) Mandati i përfaqësuesve të studentëve zgjat një vit pa të drejtë rizgjedhje.
  - (3) Procedura për shkarkimin e një anëtari të zgjedhur të Senatit mund të iniciohet nga kryetari i Senatit në rast të tre mungesave të paarsyeshme të njëpasnjëshme. Senati vendos me shumicë votash për shkarkimin. Nëse shkarkohet anëtari i zgjedhur i Senatit, informohet këshilli mësimor-shkencor i caktuar, që të propozojë një anëtar të ri të Senatit.
  - (4) Thirrja e mbledhjeve dhe puna e Senatit rregullohen me Rregulloren për punën e Senatit.

### **Kompetencat e Senatit të Universitetit**

#### **Neni 31**

##### **(1) Senati i Universitetit:**

1. Vendos për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe aplikative.
2. Zgjedh anëtarë për Konferencën ndëruniversitare me votim të fshehtë.
3. Diskuton rreth çështjeve të përgjithshme që kanë të bëjnë me punën hulumtuese-shkencore, studimin, mësimdhënien dhe lëndët mësimore në Universitetit.
4. Miraton programet studimore me rekomandimin e këshillave mësimore - shkencore të fakulteteve dhe instituteve shkencore.
5. Përcakton aktivitetet arsimore të Universitetit që duhen mbajtur në gjuhën shqipe, maqedonase dhe gjuhët ndërkombëtare në përputhje me dispozitat e Ligjit për arsimin e lartë dhe rekomandim nga këshillat mësimore – shkencore.

6. Krijon procedura për të siguruar cilësi akademike, duke përfshirë caktimin e një Komisioni për evaluim dhe miratimin e Doracakut për evaluim në përputhje me Ligjin.
7. Zbaton procedura për të siguruar reforma akademike, si dhe i miraton dhe i rishikon lëndët mësimore.
8. I propozon Bordit simbolet e Universitetit.
9. Propozon pagesën për shkollim dhe pagesa tjera që i bëhen Universitetit.
10. I propozon Bordit themelimin e njërive të brendshme organizative.
11. Me rekomandimin e Drejtorisë Rektoriale, në konsultim me Bordin e Universitetit, e përcakton numrin e studentëve që regjistrohen dhe kriteret e pranimit.
12. Përcakton politikat, kriteret, dhe procedurat e vlerësimit dhe kontrollit të performancës akademike të studentëve, me rekomandim të Drejtorisë Rektoriale.
13. Përcakton dispozitat për mësim të përjetshëm me rekomandim të Drejtorisë Rektoriale.
14. Përcakton procedurat për dhënien e kualifikimeve dhe titujve akademikë të nderit
15. Përcakton procedurat për përjashtim të studentëve për arsye akademike dhe të tjera.
16. Shqyrton politikën për mbrojtjen e pronësisë intelektuale të Universitetit dhe shfrytëzimin komercial të saj.
17. Përcakton dispozitën për këshillëdhënie për çështje të tjera, për të cilat Bordi i Universitetit, Komiteti Ekzekutiv, Rektori ose Drejtoria Rektoriale mund t'i drejtohen Senatit.
18. Verifikon, listën e kandidatëve për pozitën e Rektorit.
19. Miraton Raportin vjetor për punën e Rektorit.
20. Sjell rregulloret akademike.

21. Nga radhët e profesorëve ordinar të Universitetit zgjedh person të autorizuar për pranimin e fletëparaqitjeve për korrupsion.
22. Shqyrton buxhetin e Universitetit.
23. Shqyrton strategjinë e Universitetit.
24. Zgjedh Komisionin për pranim të studentëve në Universitet.
25. Formon Komision për vetëvlerësim.
26. Me propozim të Parlamentit Studentor të Universitetit zgjedh Avokatin Studentor.
27. Me propozim të Rektorit zgjedh dekanin nga lista prej tre kandidatëve për dekan të përcaktuar nga Këshilli mësimor-shkencor dhe vendimin për zgjedhje e dërgon për verifikim në Komitetin Ekzekutiv të Bordit të Universitetit.
28. Me propozim të Rektorit zgjedh drejtor qendre dhe vendimin për zgjedhje e dërgon për verifikim në Komitetin Ekzekutiv të Bordit të Universitetit.
29. Vendos për zgjedhje/rizgjedhje në thirrje mësimore - shkencore, shkencore, mësimore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtori të stafit.
30. Miraton Kodin etik të studentëve të Universitetit.
31. Formon Këshillin profesional për studime të doktoratës.
32. Si dhe vendos për çështje tjera të përcaktuara me Ligj dhe Statut.

### **Kryetari i Senatit**

#### **Neni 32**

- (1) Me punën e Senatit udhëheq Kryetari i Senatit.
- (2) Kryetari i Senatit zgjidhet nga senatorët me votim të fshehtë për një periudhë njëvjeçare, me të drejtën edhe për një zgjedhje.
- (3) Për zgjedhjen e Kryetarit të Senatit, Senati mund të vendosë nëse së paku dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Senatit marrin pjesë në seancë dhe vendoset me shumicën e anëtarëve aktualë.

- (4) Çdo anëtar i Senatit ka të drejtë të propozojë një kandidat për Kryetar të Senatit.
- (5) Nëse në raundin e parë nuk zgjidhet kryetari, votimi përsëritet, në mënyrë që pas çdo raundi pasues bie personi që ka marrë numrin më të vogël të votave.
- (6) Nëse asnjë person nuk merr shumicën e kërkuar të votave, procedura përsëritet duke propozuar një tjetër, d.m.th., persona të tjerë për kryetar.

### **Neni 33**

- (1) Kryetari i Senatit thërret mbledhjet e Senatit.
- (2) Kryetari i Senatit është i detyruar, me kërkesë së paku të një të pestës së anëtarëve të Senatit, ose me kërkesë të Rektorit që të thërrasë mbledhje të Senatit.
- (3) Nëse Kryetari i Senatit nuk vepron në pajtim me dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, Rektori thërret mbledhjen e Senatit.
- (4) Në rast të mungesës ose paaftësisë së Kryetarit të Senatit, mbledhjen e Senatit e kryeson Rektori.

### **Neni 34**

- (1) Mandati i Kryetarit të Senatit mbaron përpara skadimit të periudhës për të cilën është zgjedhur në rast të mosrespektimit të ligjshmërisë dhe aspektit statutor të punës së Senatit.
- (2) Senati vendos për ndërprerjen e mandatit si në mënyrën dhe procedurën për zgjedhjen e tij.

## **Rektori dhe Prorektorët**

### **Neni 35**

- (1) Rektori është organ udhëheqës që përfaqëson Universitetin, brenda dhe jashtë vendit.
- (2) Rektori zgjidhet nga radha e profesorëve ordinar me publikimin e njoftimit publik.
- (3) Rektori zgjidhet nga Bordi i Universitetit nga lista e shkurtër nga tre kandidatë të verifikuar në Senat.

- (4) Procedura për zgjedhjen e Rektorit përcaktohet nga Bordi i Universitetit.
- (5) Zgjedhja bëhet për periudhë tre vjeçare, me mundësi zgjedhje edhe për një mandat.

### **Kompetencat e Rektorit**

#### **Neni 36**

(1) Kompetencat e Rektorit të Universitetit përfshijnë:

1. Prezantimin e propozimeve para Bordit të Universitetit sa i takon karakterit arsimor dhe misionit të Universitetit, duke marrë parasysh rekomandimet dhe mendimet e Senatit dhe Drejtorisë Rektoriale.
2. Realizimin e vendimeve të sjellura nga Bordi, Komiteti Ekzekutiv dhe Senat i Universitetit.
3. Organizimin, udhëheqjen dhe menaxhimin e Universitetit dhe stafit.
4. Përgatitjen e vlerësimeve vjetore të të ardhurave dhe shpenzimeve, që do të rishikohen nga Bordi i Universitetit, si dhe menaxhimin e buxhetit dhe burimeve brenda vlerësimeve që do t'i aprovojë Bordi i Universitetit
5. Harmonizimin e veprimtarisë shkencore - hulumtuese dhe aplikative të arsimit të lartë, dhe punë të tjera të Universitetit.
6. Parashtrimin para Bordit të Universitetit, Senatit dhe Drejtorisë Rektoriale të propozimeve dhe vendimeve për çështje për të cilat shqyrtimi dhe vendimmarrja është në kompetencë të tyre.
7. Vendosjen për çështjet financiare të cilat nuk janë në kompetencë të Bordit të Universitetit.
8. Promovimin e doktorëve të shkencave dhe ndarjet e çmimeve.
9. Si dhe punë të tjera të përcaktuara me Ligjin dhe Statutin.

#### **Neni 37**

Rektori është i obliguar që deri te Senati dhe Bordi i Universitetit një herë në vit të dorëzojë raport për punën e vet dhe punën e Universitetit.

#### **Neni 38**

- (1) Rektori kujdeset dhe ka përgjegjësi për ligjshmërinë e punës së Universitetit dhe njësive të Universitetit.
- (2) Rektori mund ta suspendojë dekanin, ose drejtorin për ushtrimin e paligjshëm të detyrës së tij dhe të emërojë ushtrues detyre dekan, përkatësisht drejtor.
- (3) Kundër vendimit të Rektorit mund të parashtrahet ankesë deri tek Bordi i Universitetit.
- (4) Vendimi i Bordit lidhur me ankesën është përfundimtar.
- (5) Rektori, i përgjigjet Bordit të Universitetit për punën efikase dhe rendin në Universitet, si dhe për menaxhimin e Universitetit sipas politikave të përcaktuara nga Bordi i Universitetit.
- (6) Kryerja e funksionit të Rektorit është e papërputhshme me ushtrimin e një funksioni publik, apo funksioni në një parti politike.

### **Prorektorët**

#### **Neni 39**

- (1) Me propozim të Rektorit, Komiteti Ekzekutiv i Bordit, përcakton që fusha të veçanta të planifikimit, zhvillimit dhe përpilimit të politikave dhe koordinimit të tyre të jenë në përgjegjësi të prorektorëve.
- (2) Prorektorët zgjidhen nga Komiteti ekzekutiv i Bordit të Universitetit me propozim të Rektorit, nga stafi akademik i Universitetit.
- (3) Prorektorët asistojnë dhe përfaqësojnë Rektorin në përmbushjen e obligimeve të tij.
- (4) Kryerja e funksionit të prorektorit është e papërputhshme me ushtrimin e një funksioni publik apo funksioni në një parti politike.
- (5) Mandati i prorektorëve korrespondon me mandatin e Rektorit.

#### **Neni 40**

- (1) Mandati i Rektorit dhe Prorektorëve ndërpritet para skadimit të periudhës për të cilën janë zgjedhur në rast se:
  1. nëse ai vetë e kërkon,
  2. nëse humb në mënyre të përhershme aftësinë për ushtrimin e detyrës së rektorit, respektivisht, prorektorit,

3. nëse i përmbush kushtet për pension;
  4. nëse shkarkohet nga detyra para përfundimit të mandatit;
- (2) Rektori, gjegjësisht prorektori mund të shkarkohet nga detyra para skadimit të mandatit në rast se:
1. është dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg mbi gjashtë muaj.
  2. manifeston sjellje diskredituese për Universitetin.
  3. dëshmon për paaftësi për të kryer funksionin, si pasojë e mungesës së kapacitetit fizik, apo mental, të vërtetuar me certifikatë mjekësore.
  4. dështon, refuzon apo neglizhon në mënyrë të vazhdueshme, ose shpreh paaftësi për të kryer detyrat e postit.
- (3) Në rast të ndërprerjes së mandatit të Rektorit, deri në zgjedhjen e Rektorit të ri, Bordi i Universitetit zgjedh për ushtrues detyre Rektor njërin nga Prorektorët.

#### **Neni 41**

Kryetari i Bordit të Universitetit mund të caktojë cilindo anëtar nga stafi akademik për të ushtruar funksionin e rektorit apo prorektorit, në rast të pamundësisë së përkohshme, ose të përhershme për kryerjen e detyrës nga ana e tyre.

#### **Drejtoria e Rektoriale**

##### **Neni 42**

- (1) Drejtoria Rektoriale përbëhet nga rektori, prorektorët, dekanët e fakulteteve, drejtorët e njësive të tjera akademike dhe kryetari i Parlamentit Studentor.
- (2) Sekretari i përgjithshëm ka të drejtë të merr pjesë në mbledhjet e Drejtorisë Rektoriale.
- (3) Me Drejtorinë Rektoriale udhëheq Rektori i Universitetit.

#### **Kompetencat e Drejtorisë Rektoriale**

##### **Neni 43**

- (4) Kompetencat e Drejtorisë Rektoriale janë:



1. Të veprojë si kanal komunikimi i rregullt dhe i shpeshtë në mes të anëtarëve të tij, si dhe me anëtarë të Senatit, Rektorit, Bordit dhe Komitetit Ekzekutiv.
2. Të përgatisë çështjet që shqyrtohen nga Senati, Bordi i Universitetit, ose Komiteti Ekzekutiv.
3. Të sjell vendime mbi çështjet akademike, që i janë deleguar nga Senati dhe t'i paraqesë raport Senatit për të njëjtat.
4. Me propozim të Rektorit të miratojë datat e sesioneve, periudhave të regjistrimit, pushimeve dhe afateve të provimeve.
5. Me rekomandim të këshillave mësimor - shkencor të aprovojë caktimin e detyrave të mësimdhënies për stafin akademik.
6. Të veprojë si forum për planifikim, rregullim dhe sigurim të burimeve për qëllime akademike.
7. Të marrë vendime për çështjet urgjente akademike dhe t'i raportojë Senatit për të njëjtat.
8. Të përgatisë komente mbi propozimet e bëra nga Rektori që duhen shqyrtuar nga Senati, Bordi i Universitetit, ose Komiteti Ekzekutiv.
9. Si dhe të kryejë punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe Statut.

### **Mënyra e punës së Drejtorisë Rektoriale**

#### **Neni 44**

- (1) Drejtoria Rektoriale kryen detyrat në kuadër të kompetencës në mbledhje.
- (2) Rektori thërret mbledhjet e Drejtorisë Rektoriale dhe udhëheq me punën e tyre.
- (3) Në mungesë të tij, mbledhjet e Drejtorisë Rektoriale, do të thirren dhe drejtohen nga njëri prej prorektorëve të autorizuar nga Rektori.
- (4) Rektori i Universitetit i thërret mbledhjet e Drejtorisë Rektoriale me iniciativën e vet, ose me kërkesë të së paku të një të pestës së anëtarëve të Drejtorisë Rektoriale.
- (5) Drejtoria Rektoriale mund të vazhdojë punimet nëse më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Drejtorisë Rektoriale janë të pranishëm në mbledhje.

- (6) Vendimet Drejtorisë Rektoriale sillen me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të Drejtorisë Rektoriale.

### **Sekretari i përgjithshëm dhe Shërbimet administrative dhe profesionale**

#### **Neni 45**

- (1) Sekretari i Përgjithshëm është zyrtari më i lartë administrativ me të drejta dhe detyrime të përcaktuara në kontratën e tij të punës.
- (2) Sekretari i përgjithshëm është udhëheqës i shërbimeve profesionale dhe administrative të Universitetit.
- (3) Sekretari i përgjithshëm i Universitetit zgjidhet nga Bordi i Universitetit, me propozim të Rektorit, nga radhët e personave që posedojnë kualifikim dhe përvojë adekuate (të ketë së paku titullin - magjistër në drejtësi, biznes, administratë publike, ose lëmi ekuivalente).
- (4) Sekretari i përgjithshëm i përgjigjet, Rektorit lidhur me administrimin efikas dhe efektiv të Universitetit.
- (5) Sekretari i përgjithshëm mund të shkarkohet para përfundimit të kontratës, në rast se:
  1. Është dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg mbi gjashtë muaj.
  2. Manifeston sjellje diskredituese për Universitetin.
  3. dëshmon për paaftësi për të kryer funksionin si pasojë e mungesës së kapacitetit fizik, apo mental, të vërtetuar me certifikatë mjekësore.
  4. Dështon, refuzon apo neglizhon në mënyrë të vazhdueshme ose shpreh paaftësi për të kryer detyrat e postit.

### **Shërbimet profesionale dhe administrative**

#### **Neni 46**

- (1) Shërbimet profesionale dhe administrative të Universitetit përbëhen nga departamente të cilët i përgjigjen Sekretarit të përgjithshëm.
- (2) Struktura dhe përbërja e shërbimeve profesionale dhe administrative rregullohen me aktin për organizimin e Universitetit.

- (3) Në kuadër të departamenteve Sekretari i përgjithshëm, me miratimin e rektorit, mund të krijojë një strukturë të zyrtarëve të lartë, të përbërë nga personeli me përvojë, të cilët do ta ndihmojnë atë në menaxhimin e shërbimeve.

#### **Personi i autorizuar për pranimin e fletëparaqitjeve për korrupsion**

##### **Neni 47**

- (4) Për pengim dhe mbrojtje efikase nga korrupsioni, Senati i Universitetit nga radha e profesorëve ordinar zgjedh personin e autorizuar për pranimin e fletëparaqitjeve për korrupsion.
- (5) Procedura e zgjedhjes, organizimit dhe funksionimi të personit të autorizuar për pranimin e fletëparaqitjeve për korrupsion rregullohet me rregullore të veçantë.

#### **Organet dhe trupat e njësive të Universitetit**

##### **Organet e fakultetit**

##### **Neni 48**

- (1) Organet e fakultetit janë këshilli mësimor – shkencor, dekani dhe drejtoria e dekanatit të fakultetit.
- (2) Fakulteti mund të ketë prodekanë

##### **Këshilli mësimor – shkencor**

##### **Neni 49**

- (1) Këshilli mësimor – shkencor është organ profesional i fakultetit, me të cilin udhëheq dekani, ose në mungesë të tij, njëri prej prodekanëve.
- (2) Këshilli mësimor – shkencor është organ këshillëdhënës i Dekanit të fakultetit, i cili mund të diskutojë dhe japë mendim për çfarëdo çështje që ka të bëjë me punën e fakultetit.
- (3) Këshilli mësimor – shkencor përbëhet nga:

1. profesorët ordinarë
2. profesorët inordinar
3. docentët
4. studentët (së paku 10 %, por jo më shumë se 15% nga numri i anëtarëve të Këshillit mësimor – shkencor).
5. mandati i përfaqësuesve të studentëve në këshillin mësimor-shkencor është dy vjet.

### **Kompetencat e këshillit mësimor – shkencor**

#### **Neni 50**

(1) Kompetencat e Këshillit mësimor – shkencor janë:

1. Të përcaktojë një listë prej jo më shumë se tre kandidatësh për dekan në bazë procedurës së miratuar paraprakisht.
2. T'i propozojë Senatit emrat e personave për t'u zgjedhur në thirrje mësimore – shkencore.
3. T'i propozojë Senatit programet studimore.
4. Të propozojë anëtarët nga Këshilli mësimor – shkencor në Senat.
5. Të propozojë numrin e studentëve për tu regjistruar në vitin e parë në të gjitha ciklet e studimeve.
6. Të zgjedh anëtarët e Komisionit për vetëvlerësim.
7. Të vendos për organizimin e konferencave, simpoziumeve dhe të ngjashme.
8. Të sjell masa dhe vendos për përparimin e veprimtarisë mësimore, shkencore-hulumtuese dhe aplikative.
9. Të merr vendim për orarin e detyrave për mësimdhëniet dhe bashkëpunëtorët për secilin vit akademik.
10. Si dhe ushtron punë të tjera të përcaktuara me Ligj dhe këtë Statut.

(2) Çështjet në lidhje me sjelljen e vendimeve dhe punën e Këshillit mësimor – shkencor rregullohen me rregullore.

#### **Këshilli shkencor i Institutit**

## **Neni 51**

Institutet shkencore të akredituara për kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë themelojnë Këshill shkencor për studimet e ciklit të dytë dhe të tretë, të cilin e përbëjnë personat e zgjedhur në thirrje shkencore që janë të angazhuar në mësimdhënie.

### **Dekani i fakultetit dhe kompetencat e tij**

## **Neni 52**

- (1) Dekani i fakultetit është organ udhëheqës i fakultetit, i cili e përfaqëson fakultetin brenda dhe jashtë vendit, në pajtim me Statutin e Universitetit.
- (2) Kryerja e funksionit të dekanit dhe prodekanit është e papërputhshme me ushtrimin e një funksioni publik apo funksioni në një parti politike.
- (3) Dekani i fakultetit në kuadër të ushtrimit të funksionit të tij:
  1. Realizon vendimet dhe përfundimet e Senatit, të Rektorit dhe të këshillit mësimor – shkencor.
  2. Thërret mbledhjet e këshillit mësimor-shkencor, propozon rendin e ditës për mbledhjet dhe udhëheq me mbledhjet.
  3. Kujdeset për ushtrimin e harmonizuar të veprimtarisë shkencore – hulumtuese dhe aplikative.
  4. Si dhe ushtron punë tjera të përcaktuara me ligj, Statut dhe rregullore.
- (4) Dekani i fakultetit është i obliguar që për punën e vet t'i raportojë dhe t'i përgjigjet Rektorit.
- (5) Dekani i fakultetit mund të veprojë në emër të Universitetit, ose për çështje juridike në emër të fakultetit, me leje eksplicite të dhënë nga Rektori.
- (6) Këshilli mësimor-shkencor dorëzon propozime për vendime dhe konkluzione për çështje, shqyrtimi dhe zgjidhja e të cilave është në kompetencë të tij.
- (7) Promovon të diplomuarit dhe ndanë shpërblime.

## **Neni53**

Dekani i fakultetit i përcakton detyrat e Prodekanëve.

## **Neni54**

- (1) Dekanët e fakulteteve zgjidhen nga Senati me propozim të Rektorit nga lista e shkurtër prej jo më shumë se tre kandidatësh të përcaktuar nga këshilli mësimor-shkencor.
- (2) Dekani zgjidhet nga radha e profesorëve ordinar dhe inordinar të fakultetit.
- (3) Në rast se nuk ka kandidatë me thirrje nga paragrafi 2 i këtij neni, Dekan mund të zgjidhet edhe profesor nga radha e docentëve.
- (4) Mandati i dekanit është trevjeçar, me të drejtë edhe në një zgjedhje.
- (5) Prodekanët emërohen nga Rektori, me propozim nga dekani i fakultetit.
- (6) Rektori sjell vendim për fillimin e procedurës për zgjedhje të dekanit.
- (7) Procedura e zgjedhjes së dekanit fillon me shpalljen e konkursit për zgjedhje të dekanit.

#### **Neni 55**

Nëse në afat të caktuar me Ligj dhe Statut nuk zgjidhet dekani, më së voni në afat prej tre ditëve, rektori emëron ushtrues detyre dekan, mandati i të cilit mund të zgjasë më së shumti gjashtë muaj.

#### **Neni 56**

- (1) Mandati i dekanit mund të ndërpritet para përfundimit nëse:
  1. Jep dorëheqje nga funksioni.
  2. Krijohet pengesë e përhershme për ushtrimin e funksionit.
  3. Senati konfirmon vendimin e Rektorit për të pezulluar dekanin.
  4. Si dhe në raste tjera të përcaktuara me Ligj dhe Statut.

#### **Drejtoria e dekanatit**

#### **Neni 57**

- (1) Drejtoria e dekanatit është organ qeverisës i fakultetit.
- (2) Drejtorinë e dekanatit e përbëjnë dekani, prodekanët, titullarët e njësive të tjera organizative të fakultetit, të emëruar nga dekani për periudhë prej tre vitesh, me mundësi edhe për një zgjedhje, si dhe përfaqësues të studentëve të fakultetit, të propozuar nga Parlamenti Studentor.

### **Neni 58**

- (1) Mbledhjet e Drejtorisë së dekanatit i thërret dekani dhe udhëheq me to.
- (2) Në kuadër të kompetencave të veta Drejtoria e dekanatit ka këto përgjegjësi:
  1. kujdeset për realizimin e veprimtarisë dhe zhvillimit të fakultetit, si dhe për marrëdhëniet me komunitetin më të gjerë shoqëror dhe organet shtetërore;
  2. përgatit dhe propozon aktet dhe materialet për çështje për të cilat vendos këshilli mësimor- shkencor dhe dekani; dhe
  3. çështje tjera të përcaktuara me Statutin e Universitetit.
- (3) Drejtoria e dekanatit takohet së paku njëjarë në javë.

### **Këshilli për bashkëpunim dhe besim me publikun**

#### **(Ekipet e cilësisë)**

### **Neni 59**

Për të realizuar bashkëpunim dhe besim me publikun, komunitetin e biznesit, dhomat profesionale dhe institucionet dhe shoqatat e tjera qytetare nga rajoni, ku ushtron veprimtarinë mësimore - shkencore të arsimit të lartë, si dhe për të realizuar publicitet dhe përgjegjësi për kryerjen e veprimtarisë me interes publik, fakulteti në pajtim me Ligjin formon Këshill për bashkëpunim dhe besim me publikun.

## **V. VEPRIMTARIA E UNIVERSITETIT DHE NJËSIVE**

### **Veprimtaria e Universitetit**

### **Neni 60**

- (1) Veprimtaria kryesore e Universitetit është të arsimojë studentë dhe të zhvillojë shkencën.
- (2) Universiteti integron funksionet e njësive të veta (integrim funksional) dhe nëpërmjet organeve të veta siguron veprimtarinë e harmonizuar të tyre me:

1. Realizimin e zhvillimit të përbashkët strategjik;
2. Sjelljen e standardeve, normativave dhe rregullave për organizimin dhe kryerjen e veprimtarisë së arsimit të lartë dhe veprimtarisë shkencore – hulumtuese;
3. Realizimin e Sistemit Evropian të Transferimit të Kredive (SETK);
4. Realizimin e veprimtarive aplikative dhe të specializuara;
5. Veprime të koordinuara në sektorin financiar, investimet dhe planet zhvillimore;
6. Profilizimin e hulumtimit shkencor dhe mbështetjen e tyre financiare,
7. Përcaktimin e kushteve të veçanta për zgjedhje në thirrje, për avancim në thirrje mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore dhe bashkëpunëtori;
8. Bashkëpunimin me universitetet brenda dhe jashtë vendit,
9. Zhvillimin e politikave për mobilitet të studentëve, të mësimdhënësve të bashkëpunëtorëve dhe të stafit administrativ;
10. Krijimin e rregullave për shfrytëzim racional të burimeve njerëzore dhe materiale;
11. Organizimin e studentëve dhe zhvillimin e aktiviteteve të tyre jashtë arsimit;
12. Krijimin e sistemit për sigurim dhe kontroll të cilësisë dhe vendosjen e standardeve në arsim;
13. Krijimin e sistemit informativ;
14. Krijimin e sistemit bibliotekar;
15. Realizimin e veprimtarisë botuese;
16. Dhënien e diplomave;
17. Organizimin e tubimeve shkencore dhe artistike;
18. Lëshimin e formularëve dhe dokumenteve të tjera për nevojat e studentëve;



19. Organizimin e shërbimit profesional, respektivisht, shërbimit teknik administrativ;
20. Udhëheqjen dhe ruajtjen e dokumentacionit universitar;
21. Kujdes për mbrojtjen dhe promovimin e standardeve për studentët dhe stafin;
22. Krijimi e një programi për shkëmbimin e shërbimeve dhe produkteve shkencore dhe profesionale me personat fizikë dhe juridikë vendas dhe të huaj;
23. Sigurimin e pronës së Universitetit;
24. Si dhe kryerjen e veprimtarive të tjera në përputhje me ligj dhe Statut.

### **Veprimtaria e njësive të Universitetit**

#### **Fakultetet**

##### **Neni 61**

- (1) Fakultetet janë njësi brenda Universitetit, që realizojnë veprimtari shkencore-hulumtuese të arsimit të lartë në fusha konkrete akademike, apo lëmi të përafërta, duke vepruar nëpërmjet Këshillit mësimor - shkencor të fakultetit dhe në kuadër të politikave të Universitetit të miratuara nga organet e Universitetit.
- (2) Fakultetet në kuadër të veprimtarisë së vet:
  1. planifikojnë realizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve për të cilat janë themeluar;
  2. realizojnë arsimin e lartë, hulumtimin-shkencor dhe veprimtarinë e aplikuar në një ose më shumë disiplina shkencore dhe profesionale përkatëse, përkatësisht të ndërlidhura.
  3. Realizojnë bashkëpunim ndërkombëtar me institucione të ngjashme të arsimit të lartë dhe institucione shkencore në përputhje me Statutin e Universitetit;
  4. Organizojnë mbledhje shkencore, simpoziume, seminare, këshillime dhe lloje të tjera të tubimeve;

5. Propozojnë dhe marrin masa për të promovuar dhe mbrojtur standardin e studentëve dhe stafit;
6. Kryejnë studime të ndryshme për përmirësimin, thellimin, ose zgjerimin e njohurive dhe edukimin e vazhdueshëm;
7. Shkëmbejnë shërbime dhe produkte shkencore dhe profesionale me personat fizikë dhe juridikë vendas dhe të huaj;
8. Angazhohet në çështjet që lidhen me përparimin akademik të studentëve;
9. Angazhohet në çështjet që lidhen me angazhimin e stafit siç përcaktohet në këtë Statut.
10. Kryejnë veprimtari të tjera të përcaktuara me Ligj dhe me Statutin e Universitetit.

#### **Instituti shkencor si ushtrues i veprimtarisë së arsimit të lartë**

##### **Neni 62**

- (3) Instituti shkencor mund të ushtrojë veprimtari të arsimit të lartë në studimet e ciklit të dytë dhe ciklit të tretë nëse është akredituar dhe ka vendim për fillim me punë.
- (4) Instituti shkencor në përbërje të Universitetit mund të ushtrojë veprimtari të arsimit të lartë në ciklin e dytë edhe në bashkëpunim me njësinë, e cila ka programe studimore të fushës së njëjtë ose të përafërt.

### **VI.STUDENTËT DHE ORGANIZATAT E STUDENTËVE**

#### **Statusi i studentit**

##### **Neni 63**

- (1) Statusi i studentit fitohet me regjistrim në ciklin e parë, të dytë apo të tretë të studimeve në Universitet.
- (2) Regjistrimi i studentëve bëhet në bazë të konkursit publik, që e shpall Universiteti në pajtim me Ligjin dhe Rregulloren e miratuar nga Senati.
- (3) Rregullorja përfshinë dispozita edhe për studentët e transferuar nga universitetet tjera, të cilët detyrimisht duhet të kryejnë se paku një vit studimi të rregullt akademik në UEJL.

- (4) Me regjistrim studenti bëhet anëtar i bashkësisë akademike.
- (5) Statusi i studentit dëshmohet me legjitimacion studentor (ID kartelë);
- (6) Studentët mund të kenë status të studentit të rregullt dhe me korrespondencë.

### **Të drejtat dhe detyrimet e studentëve**

#### **Neni 64**

(1) Të drejtat e studentëve janë:

1. të drejtë në studime kualitative dhe proces arsimor ashtu siç është paraparë në programet studimore;
2. të drejtë në shprehje të lirë të mendimeve dhe qëndrimeve gjatë mësimit dhe aktiviteteve të tjera në Universitet;
3. të drejtë të deklarohen lidhur me cilësinë e mësimdhënies dhe mësimdhënësve;
4. të drejtë të marrin pjesë në zgjedhje, të zgjedhin dhe të zgjidhen (të drejtë aktive dhe pasive të votës), për pozitat e studentëve në organet e Universitetit;
5. të drejtë të marrin kartelë identiteti;
6. të drejtë të marrin certifikatat e notave në fund të çdo viti akademik;
7. të drejtë të shfrytëzojnë kapacitetet e bibliotekave të Universitetit, mjetet në funksion të veprimtarisë dhe shërbimet tjera studentore;
8. të drejtë në tubime të qeta studentore;
9. të drejtë të mbrojtjes së të drejtave të tyre para organeve të Universitetit;
10. të drejtë në mbrojtje të personalitetit dhe dinjitetit;
11. si dhe të drejta të tjera të përcaktuara me Ligj, Statut dhe rregullore të Universitetit.

(2) Detyrimet e studentëve janë:

1. të përmbushin detyrat e përcaktuara në programet studimore;

2. të respektojnë aktet e Universitetit;
3. të kenë konsideratë ndaj të drejtave të stafit dhe studentëve tjerë;
4. të marrin pjesë në aktivitetet akademike të organizuara nga Universiteti;
5. të kujdesen për ruajtjen dhe rritjen e imazhit të Universitetit.
6. të respektojnë Kodin etik të studentëve të miratuar nga Senati i UEJL.

### **Rregullat e studimit**

#### **Neni 65**

Me akt të përgjithshëm të Universitetit rregullohen procedurat dhe rregullat e studimit, si: kalendari studentor, procedurat e regjistrimit, regjimi i provimeve, përparimi, përfundimi i studimeve, transferi në programe studimore, përsëritja e semestrit dhe çështje të tjera lidhur me studimin.

### **Ndërprerja e statusit të studentit**

#### **Neni 66**

- (1) Studentit i ndërpritet statusi i studentit sipas kushteve të përcaktuara me Ligj, Statut dhe rregullore të Universitetit.
- (2) Statusi i studentit ndërpritet nëse studenti:
  1. Diplomon;
  2. Nuk i kryen studimet në afatin e paraparë me Ligj, Statut apo rregullore;
  3. Çregjistrohet;
  4. Në raste të tjera të përcaktuara me rregullore dhe akte të Universitetit.
- (3) Statusi i studentit mund të rikthehet.
- (4) Studenti, të cilit i rikthehet statusi i studentit, mund t'i vazhdojë studimet sipas Rregullores së Universitetit, sipas programit të akredituar studimor;
- (5) Në rastet kur programi i studimor nuk është më i vlefshëm, studenti është i detyruar të dëgjojë, përmbushë dhe kryejë obligimet shtesë në përputhje me programin e studimor.

### **Përgjegjësia disiplinore e studentëve**

#### **Neni 67**

Gjatë studimeve, studentët duhet t'i përmbahen Ligjit, Statutit të Universitetit dhe rregulloreve të Universitetit.

### **Llojet e shkeljeve disiplinore**

#### **Neni 68**

(1) Shkelje të lehta disiplinore janë:

1. Prishje të rendit dhe qetësisë publike dhe sjelljes së pahijshme ndaj mësimeve, ose punonjësve të tjerë, si dhe kundër studentëve të tjerë gjatë mësimit.
2. Regjistrimin i prezencës në mësim për një student tjetër.
3. Sjellje e papërshtatshme ndaj pronës së Universitetit

(2) Shkeljet të rënda disiplinore janë:

1. Kopjimi dhe përdorimi i pajisjeve për komunikim telefonik dhe elektronik gjatë provimeve.
2. Plagjiaturë në çfarëdo lloj formë.
3. Sulm fizik, duke shkaktuar lëndime të lehta, ose të rënda trupore.
4. Fyerje verbale, ose reale të një mësimeve, ose bashkëpunëtorit.
5. Dhënia e të dhënave të pasakta në shërbimet e Universitetit.
6. Ndërhyrje në sistemin e informacionit të Universitetit.
7. Dëmtimi i pronës.
8. Shkelje të lehta disiplinore të përsëritura.

### **Llojet e masave disiplinore**

#### **Neni 69**

(1) Për shkelje të detyrave dhe për mospërbushjen e detyrimeve, studentit mund t'i shqiptohet masa disiplinore:

1. vërejtje,
2. vërejtje publike, dhe
3. përjashtim (zbatohet për vitin akademik në të cilin është shqiptuar).

(2) Inicimi dhe rrjedha e procedurës disiplinore rregullohet me rregullore.

- (3) Procedura disiplinore udhëhiqet nga komisioni i përbërë nga tre anëtarë, dy nga të cilët janë nga radhët e mësimdhënësve dhe një anëtar është përfaqësues i studentëve.
- (4) Anëtarët e komisionit disiplinor zgjidhen nga këshilli mësimor-shkencor.

### **Avokati i studentëve**

#### **Neni 70**

- (1) Për mbrojtjen e të drejtave të studentëve, nga radhët e studentëve të rregullt të Universitetit, zgjidhet avokati i studentëve.
- (2) Zgjedhja e avokatit të studentëve bëhet nga Senati i Universitetit me shumicë të votave të anëtarëve, në bazë të konkursit publik, me propozim të Parlamentit Studentor të Universitetit.
- (3) Mandati i avokatit të studentëve është dy vite pa të drejtë rizgjedhje.
- (4) Kompetencat, procedura e zgjedhjes, shkarkimit si dhe çështjet tjera me rëndësi për avokatin e studentëve rregullohen me rregullore të Universitetit.

### **Organizimi dhe pjesëmarrja e studentëve në qeverisje**

#### **Organizimi studentor**

#### **Neni 71**

- (1) Parlamenti Studentor është trup i Universitetit, në të cilën anëtarësohen nga së paku dy përfaqësues të fakulteteve me mandat njëvjeçar dhe të drejtë edhe për një zgjedhje.
- (2) Kryetari i Parlamenti Studentor zgjidhet nga radhët e përfaqësuesve të studentëve në Parlament me mandat njëvjeçar dhe të drejtë edhe për një zgjedhje.
- (3) Për punën e Parlamenti Studentor dhe avokatit të studentëve, Universiteti siguron kushte dhe hapësira për punë.
- (4) Puna e Parlamenti Studentor financohet nga mjetet financiare të Universitetit, si dhe nga burime të tjera brenda kornizave buxhetore të Universitetit.
- (5) Parlamenti Studentor ka Statutin, që miratohet nga Bordi i Universitetit, me pëlqim paraprak nga Senati.

(6) Me Statutin e Parlamentit Studentor rregullohen organizimi, kompetencat, të drejtat dhe detyrat si dhe çështje tjera të rëndësishme për Parlamentin Studentor.

(7) Parlamenti Studentor punon në pajtim me Ligjin për arsim të lartë, me këtë Statut, Statutin e Parlamentit Studentor dhe me rregullore të Universitetit.

### **Pjesëmarrja e studentëve në qeverisje**

#### **Neni 72**

(1) Studentët marrin pjesë në qeverisje të Universitetit nëpërmjet të përfaqësuesve të zgjedhur në:

1. Parlamentin Studentor të Universitetit;
2. Në organet e Universitetit dhe njësitë, në pajtim me Ligjin;
3. Nëpërmjet formave të vetë-organizimit;
4. Në mënyrë tjetër sipas kushteve të përcaktuara me Ligj dhe Statut.

### **Alumni i studentëve**

#### **Neni 73**

Studentët e diplomuar në Universitet kanë të drejtë të themelojnë asociacionin Alumni. Funkzioni dhe organizmi i Alumnit rregullohet me Statut të miratuar nga Bordi me pëlqim paraprak nga Senati i Universitetit.

## VII. FINANCIMI DHE PASURIA E UNIVERSITETIT

### Parimet bazike të menaxhimit financiar

#### Neni 74

- (1) Universiteti kujdeset për menaxhim fiskal prudent dhe në përputhje me parimet bazike të mirëqeverisjes financiare: Transparencës, Përgjegjësisë, Efiçencës dhe Llogaridhënies (Transparency, Responsibility, Efficiency and Accountability). Të gjitha këto duke u bazuar në Modelin e Alokimit sipas burimeve (RAM-Resouce Allocation Model).
- (2) Universiteti krijon mekanizma adekuat që do të mundësojnë matshmëri dhe vlerësim kredibël me Rregullore të veçantë për financimin e Universitetit, në përputhje me këtë Statut dhe Ligjin për arsim të lartë.

### Burimet e financimit të Universitetit

#### Neni 75

- (1) Universiteti financohet nga burimet vijuese:
  1. Të ardhurat nga pagesat studentore (*tuition fees*);
  2. Të ardhurat që gjenerohen nga projektet, hulumtimet dhe shërbimet komerciale;
  3. Të ardhurat nga Buxheti i shtetit dhe fondeve tjera publike, për studime me interes publik dhe të mira tjera publike;
  4. Të ardhurat nga donacionet vendore dhe të huaja;
  5. Të ardhurat nga asetet dhe prona e Universitetit;
  6. Të ardhura tjera (kamata, kontribute, dhurata, testamente,...etj.).
- (2) Universiteti pretendon ta diversifikojë dhe përmirësojë strukturën e të ardhurave të veta nga më shumë burime me tendencë të rritjes permanente të të ardhurave nga buxheti i shtetit dhe fondet publike, nga projektet, shërbimet dhe stilizimi i aseteve.

#### Neni 76

- (1) Të gjitha të ardhurat e Universitetit, pavarësisht burimeve të tyre, në mënyrë primare përdoren për veprimtarinë arsimore dhe shkencore të Universitetit.



- (2) Investimet me dedikimet eventuale sekondare (investime në asete, apo kapacitete të shtuara), gjithmonë duhet të mbeten të lidhura për efektet primare arsimore, shkencore dhe kulturore.

#### **Neni 77**

- (1) Të ardhurat nga buxheti i shtetit (publike), duhet të dedikohen për krijim të interesit dhe të mirave publike meritore në Universitet me prioritet në:
1. impakt në programe studimore me interes publik dhe shoqëror;
  2. impakt në krijim të profileve profesionale dhe shkencore adekuate për rritjen e punësueshmërisë dhe efekteve socio-ekonomike;
  3. impakt në përmirësimin dhe rritjen e standardit studentor dhe mundësive studentore;
  4. impakt në përmirësimin e shërbimeve dhe mbështetjes së komunitetit dhe shoqërisë në përgjithësi;
  5. impakt në vlerat multikulturore (etnike, gjuhësore, fetare,...) të shoqërisë dhe i hapur për të gjithë;
  6. impakt në mjedisin jetësor dhe ngritjen e vetëdijes për mjedisin jetësor; dhe
  7. dhe prioritete të tjera të ngjashme.
- (2) Për të gjitha këto dispozita, Universiteti në mënyrë të rregullt raporton te financuesi përkatës.

#### **Neni 78**

- (1) Planifikimi, alokimi dhe shfrytëzimi i të ardhurave përcaktohet me Buxhetin afatmesëm (3 vjeçar) dhe vjetor.
- (2) Buxhetin dhe llogarinë vjetore të Universitetit, sipas kalendarit fiskal-akademik të Universitetit, pasiqë ta ketë dizajnuar shërbimi financiar përkatës, e propozon Rektori dhe e miraton Bordi i Universitetit.
- (3) Në situatat kur shmangia e buxhetit në pjesën e shpenzimeve tejkalon 5% të vlerës së përgjithshme të buxhetit vjetor, Rektori propozon ribalanc të buxhetit, të cilin sërish e miraton Bordi i Universitetit.
- (4) Deficiti vjetor i punës së Universitetit nuk mund të kalojë 5% të vlerës së të ardhurave totale të Universitetit, pa miratimin e Bordit.

## **Mjetet (Asetet) e Universitetit**

### **Neni 79**

- (1) Mjetet e Universitetit i takojnë vetë Universitetit.
- (2) Universiteti posedon dhe utilizon mjetet e veta në mënyrë prudente dhe të kujdeshme.
- (3) Zhvlerësimi (amortizimi) i mjeteve bëhet konform ligjit dhe rregullave që përcaktojnë shkallën e amortizimit në të njëjtën mënyrë siç vlen për asetet publike (Nomenklatura e Amortizimit për sektorin publik).

## **VIII. VEPRIMTARIA E ARSIMIT TË LARTË**

### **Ciklet e arsimit të lartë**

#### **Neni 80**

- (1) Arsimi i lartë realizohet nëpërmjet studimeve akademike dhe të specializuara në bazë të programeve të akredituara dhe sipas rregullave të studimit të bazuara në sistemin evropian për transfer dhe akumulim të kredive (*ECTS - European Credit Transfer and Accumulation System*).
- (2) Në Universitet organizohen tri cikle të studimit në pajtim me Deklaratën e Bolonjës.
- (3) Pas përfundimit të studimeve nga paragrafi 2, studenti fiton kualifikim përkatës të përcaktuar me Ligjin mbi Kornizën Nacionale të Kualifikimeve dhe Kornizën Evropiane të Kualifikimeve të Arsimit të Lartë.

### **Cikli i parë i studimeve akademike-studime deridiplomike**

#### **Neni 81**

- (1) Cikli i parë i studimeve akademike - studime deridiplomike realizohet në pajtim me ligjin, Statutin dhe rregulloren e veçantë.
- (2) Titulli i të diplomuarit (bachelor - cikli i parë) fitohet me akumulimin e 180 ose 240 kredi në periudhë prej tre vjet (gjashtë semestra), respektivisht, katër vjet (tetë semestra), qofshin ato studime të rregullta, apo me korrespondencë.

- (3) Mënyra e vlerësimit të performancës së studentëve të ciklit të parë të studimeve deridiplomike është përcaktuar me rregullore të miratuar nga Senati.

### **Cikli i dytë i studimeve - studime pasdiplomike**

#### **Neni 82**

- (1) Cikli i dytë i studimeve realizohet në pajtim me Ligjin, Statutin dhe rregulloren e veçantë.
- (2) Në universitet realizohen studime të ciklit të dytë si:
1. Cikli i dytë i studimeve akademike (studime pasdiplomike),
  2. Cikli i dytë i studimeve profesionale.

### **Cikli i dytë i studimeve akademike (studime pasdiplomike)**

#### **Neni 83**

- (1) Titulli i magjistrat fitohet pas përfundimit me sukses të studimeve ekuivalente me 60 'ECTS' kredi (dy semestra), ose 120 'ECTS'kredi (katër semestra) dhe mbrojtjes me sukses të tezës së magjistraturës.
- (2) Në studime pasdiplomike mund të regjistrohen studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve ekuivalente me 180 kredi, respektivisht 240 kredi, në Universitet, ose në ndonjë institucion tjetër të njohur nga Universiteti, në pajtim me Ligjin.
- (3) Studentët e ciklit të dytë të studimeve, duhet të përfundojnë studimet brenda periudhës maksimale, që paraqet dyfishin e kohës së studimeve të theksuara në paragrafin 1 të këtij neni.
- (4) Mënyra e vlerësimit të performancës së studentëve në ciklin e dytë të studimeve, si dhe të gjitha çështjet tjera në lidhje me regjistrimin, procedurën e paraqitjes, vlerësimit dhe mbrojtjes së tezës së magjistraturës përcaktohet me Rregullore të miratuar nga Senati.

### **Ciklit i dytë i studimeve profesionale**

#### **Neni 84**

- (1) Në Universitet organizohen studime profesionale të Ciklit të dytë në kohëzgjatje prej një viti me përfundimin e të cilave akumulohen 60 kredi ECTS

dhe fitohet titulli profesional i përshtatshëm në përputhje me Kornizën nacionale të kualifikimeve të arsimit të lartë të përcaktuar me Ligjin për kornizën nacionale të kualifikimeve në arsimin e lartë.

- (2) Studenti obligohet që të punojë punim të specializuar si pjesë përfundimtare të programit studimor të profesional.

### **Cikli i tretë i studimeve universitare - Studimet e doktoratës**

#### **Neni 85**

- (1) Cikli i tretë i studimeve-Studimet e doktoratës realizohen në pajtim me ligjin, Statutin dhe rregulloren e veçantë.
- (2) Titulli doktor shkence fitohet:
1. Pas përfundimit me sukses të studimeve të doktoratës për një periudhë prej së paku tri viteve (180 ECTS) dhe pas fitimit të titullit Magjistër (cikli i dytë), qoftë nga Universiteti, ose ndonjë institucion tjetër i njohur nga Universiteti në përputhje me Ligjin dhe
  2. Mbrojtjes me sukses të tezës së doktoratës, ku janë të përfshira të gjitha rezultatet punës hulumtuese - shkencore
- 2.1 Disertacioni i doktoratës duhet të dorëzohet për kontroll më së voni deri në përfundim të periudhës, që është sa dyfishi i periudhës së studimeve në të cilën është regjistruar kandidati.
- (3) Procedura e paraqitjes, vlerësimit dhe mbrojtjes së disertacionit të doktoratës përcaktohet me rregullore të veçantë të miratuar nga Senati, për të cilat duhet të aplikohet sistemi i kredive.
- (4) Përmbajtja e programit hulumtues për marrjen e titullit doktor shkence miratohet nga Këshilli mësimor – shkencor.
- (5) Senati formon këshill profesional për studime të doktoratës. Përbërja, kompetencat dhe mënyra e punës së Këshillit të doktoratës përcaktohen me rregullore.
- (6) Përmbajtja e programeve studimore për fitimin e titullit të diplomuarit (bachelor), titullit të magjistrisë dhe titullit të doktorit të shkencës përcaktohen

me Rregulloren për përmbajtjen e programeve studimore të sjellur nga Këshilli Nacional për Arsimin e Lartë.

#### **Neni 86**

- (1) Viti akademik fillon më 1 tetor dhe mbaron me 30 shtator të vitit të ardhshëm.
- (2) Mësimi realizohet në dy semestra sipas kalendarit akademik të përcaktuar nga Senati dhe në përputhje me dispozitat e nenit 152 të Ligjit për arsim të lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- (3) Studentët në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve duhet të përfundojnë studimet e tyre në një periudhë jo më të gjatë se dyfishi i kohës së përcaktuar në programin përkatës të studimit.

### **IX. PROGRAMET STUDIMORE**

#### **Neni 87**

- (1) Studimet në Universitet organizohen sipas programeve studimore të propozuara nga Këshillat mësimor-shkencor të njësive dhe të miratuara nga Senati, pas mendimit paraprak të Drejtorisë Rektoriale.
- (2) Universiteti mund të organizojë programe studimi ndërdisiplinore, të cilat realizohen nga dy ose më shumë njësi në Universitet.
- (3) Akreditimi i programeve studimore bëhet nga organi kompetent në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtim me Ligjin.
- (4) Programet studimore të akredituara shpallen në ueb faqen e Universitetit dhe në mënyrë tjetër më së voni deri në shpalljen e konkursit për regjistrim të studentëve.

#### **Përmbajtja e programeve studimore**

#### **Neni 88**

- (1) Programet studimore të Ciklit të parë, Ciklit të dytë dhe Ciklit të tretë krijohen sipas normativave, standardeve dhe metodologjisë së pranuar në hapësirën unike evropiane të arsimit të lartë, ashtu që mundësojnë krahasim me programet e institucioneve të arsimit të lartë në atë hapësirë.

- (2) Profili, qëllimet, bazat dhe komponentët e detyrueshme, që duhet të përmbajnë programet studimore më për së afërmi përcaktohen nga Këshilli nacional për arsim të lartë dhe veprimtari shkencore-hulumtuese i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- (3) Programet studimore përmbajnë lëndë të detyrueshme dhe zgjedhore.
- (4) Universiteti, respektivisht, njësitë e tij 10% të lëndëve të detyrueshme dhe 10% të lëndëve zgjedhore nga çdo vit studimor i realizojnë nëpërmjet mësimin klinik, i cili rregullohet me rregullore.
- (5) Çdo vit studimor studenti realizon mësim praktik, i cili nuk mund të zgjasë më pak se 30 ditë, si njëri prej kushteve për regjistrimin e vitit vijues akademik.
- (6) Programet e studimit në pjesën e lëndëve të detyrueshme dhe zgjedhore mësimore mund të përmbajnë edhe "dritare për mobilitet", përkatësisht lëndë mësimore aktivitetet e të cilave mund të realizohen edhe në gjuhën angleze.
- (7) Kur Universiteti realizon program studimor për fitimin e diplomës së përbashkët me Universitetin e huaj, zbatohen rregullat e institucionit të arsimit të lartë ku realizohet program studimor.

### **Programe për përsosje të specializuar dhe profesionale**

#### **Neni 89**

- (1) Universiteti krijon kushte hapësinore dhe kadrovike për organizimin e programeve të ndryshme për përsosje të specializuar dhe profesionale, të cilat i sjell këshilli mësimor - shkencor, respektivisht, Senati i Universitetit.
- (2) Të drejtë të regjistrohen në këto programe kanë studentët që kanë përfunduar ciklin e parë, të dytë apo të tretë të studimeve dhe persona që kanë përfunduar shkollën e mesme, nëse kjo është përcaktuar me program përkatës.
- (3) Regjistrimi bëhet në bazë të konkursit.
- (4) Pjesëmarrësve, të cilët kanë ndjekur këto programe Universiteti/Fakulteti u ndan vërtetime, respektivisht certifikata, të nënshkruara nga Rektori, respektivisht, Dekani.
- (5) Universiteti mund të organizojë mësim joformal.

(6) Në Universitet mund të organizohen programe për arsimim të specializuar në kohëzgjatje më të shkurtë se tre vjet.

(7) Dispozita më të përafërta lidhur me këto programe janë të përmbajtura në rregulloret e Universitetit.

### **Program studimor për diplomë të përbashkët**

#### **Neni 90**

Në Universitet mund të miratohet dhe të zbatohet program studimor për fitimin e diplomës së përbashkët në pajtim me ligjin.

### **Transferi i kredive**

#### **Neni 91**

(1) Kreditë mund të transferohen nga një program studimor në programin tjetër në kuadër të njësisë ose të Universitetit, si edhe në Universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit.

(2) Kriteret dhe kushtet për bartjen e kredive më për së afërmi rregullohen me rregullore.

### **Mënyra e regjistrimit të studimeve**

#### **Neni 92**

(1) Regjistrimi i studimeve kryhet në bazë të konkursit publik të shpallur nga Universiteti, së paku pesë muaj përpara fillimit të studimeve.

(2) Konkursi për regjistrimin e studimeve përmban:

1. Emrin e Universitetit,
2. Titullin e programit studimor,
3. Vendin e realizimit të programit studimor,
4. Kohëzgjatjen e studimeve,
5. Kushtet e regjistrimit,
6. Numri i parashikuar i vendeve të lira për regjistrim,
7. Procedurat dhe afatet për aplikim për regjistrimin e studimeve,
8. Shuma e tarifave të shkollimit, respektivisht, participimin,

9. Kriteret në bazë të të cilave bëhet selektimi dhe përzgjedhja e kandidatëve për regjistrimin e studimeve.

**Promovimi i personave që kanë përfunduar programet e ciklit të tretë në studimet akademike - studimet e doktoratës dhe kanë marrë titullin shkencor Doktor i Shkencave**

**Neni 93**

- (1) Promovimi i personave që kanë mbaruar programet e doktoraturës – cikli i tretë dhe kanë marrë titullin shkencor doktor i shkencës, bëhet nga rektori.
- (2) Promovimi i kandidatëve bëhet çdo vit në ditën e shënimit të përvjetorit të Universitetit.
- (3) Promovimi është një ngjarje solemne e ndjekur nga kandidatët që promovohen, pro-rektorët, dekanët, ose drejtorët e njësive, mentorëve dhe të tjerëve.
- (4) Gjatë promovimit, kandidatëve ju jepen diplomat për gradën shkencore të fituar Doktor i Shkencave.

**X. THIRRJET MËSIMORE - SHKENCORE, MËSIMORE – PROFESIONALE, MËSIMORE, SHKENCORE DHE THIRRJET PËR BASHKËPUNËTORËT**

**Neni 94**

- (1) Të punësuarit në Universitet janë personat e zgjedhur në thirrje mësimore - shkencore dhe profesionale, si dhe thirrjet për bashkëpunëtor që ushtrojnë veprimtari arsimore (kuadri arsimor) dhe personat e punësuar në shërbimet profesionale dhe administrative (kuadri jo arsimor).
- (2) Personat e huaj mund të ushtrojnë veprimtari arsimore në kushte të përcaktuara me ligj.
- (3) Të drejtat dhe detyrat e kuadrit joarsimor rregullohen me dispozita ligjore.

**Neni 95**

Veprimtari në arsimin e lartë mund të ushtrojë vetëm personi i zgjedhur në thirrje mësimore shkencore apo profesionale si dhe në thirrje për bashkëpunëtor në kohën për të cilën është zgjedhur.



## **Llojet e thirrjeve**

### **Neni 96**

- (1) Thirrjet mësimore - shkencore janë;
1. docent, në qarkullimin ndërkombëtar si Assistant Professor, me shkurtesën - Ass. Prof. Dr.sc,
  2. profesor inordinar, në qarkullimin ndërkombëtar si Associate Professor, me shkurtesën Assoc. Prof. Dr. sc, dhe.
  3. profesor ordinar, në qarkullimin ndërkombëtar si Professor, me shkurtesën si Prof.Dr.sc.
- (2) Në ato fakultete, ku zhvillohet mësim për gjuhë, thirrje mësimore - profesionale janë: lektor dhe lektori i lartë.

### **Neni 97**

Personi i zgjedhur në thirrje mësimore - shkencore gjatë një semestri mund të zhvillojë ligjërata në më së shumti katër lëndë në ciklin e parë, apo ciklin e dytë studimor në Universitet.

### **Neni 98**

- (1) Në Fakultet thirrja për bashkëpunëtor është asistent.
- (2) Bashkëpunëtorët zgjidhen në thirrje në sfera të përcaktuara me klasifikimin e sferave hulumtuese - shkencore (klasifikimi i Frascatit).
- (3) Bashkëpunëtorët marrin pjesë në procesin arsimor në mënyrë dhe vëllim të përcaktuar me Statut dhe rregullore.
- (4) Kushtet, procedura, si dhe çështje tjera në lidhje me zgjedhjen e bashkëpunëtorëve rregullohen me rregullore.

## **Demonstratorët**

### **Neni 99**

- (1) Në fakultete, në ciklin e parë studimor, mund të zgjidhen edhe demonstrator.
- (2) Demonstrator mund të zgjidhet student i ciklit të dytë, apo tretë studimor.
- (3) Demonstrator mund të zgjidhet studenti, i cili gjatë studimeve në ciklin e parë studimor ka arritur notë mesatare prej së paku 8.00 (tetë).

- (4) Demonstratori zgjidhet në periudhë prej një viti akademik, me të drejtë edhe dy herë të zgjidhet në të njëjtën njësi në Universitete.
- (5) Kushtet, procedura, si dhe çështje tjera në lidhje me zgjedhjen e demonstratorëve rregullohen me rregullore.

### **Kriteret dhe kushtet për zgjedhje në thirrje**

#### **Neni 100**

Kriteret për zgjedhje në thirrje janë: arsimit i fituar, rezultati nga puna hulumtuese-shkencore, rezultati nga përvoja dhe veprimtaria arsimore si dhe përgatitja e kuadrit të ri arsimor.

#### **Neni 101**

Zgjedhja në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale, mësimore dhe thirrje bashkëpunëtori bëhet në bazë të kriterëve dhe kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj dhe në bazë të kushteve të veçanta të përcaktuara me rregulloren e Universitetit për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale, mësimore dhe thirrje bashkëpunëtori.

### **Afatet për të cilat bëhet zgjedhja**

#### **Neni 102**

- (1) Zgjedhja në thirrjen: docent dhe profesor inordinar bëhet për afat prej 5 (pesë) vitesh. Profesori ordinar i zgjedhur e mban thirrjen profesor ordinar gjatë tërë jetës dhe themelon marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar.
- (2) Lektori dhe lektori i lartë zgjidhen në afat prej 4 (katër) vitesh.
- (3) Asistenti zgjidhet në afat prej 3 (tre) vitesh, me të drejtë edhe në një zgjedhje në thirrjen e njëjtë në të njëjtin institucion.

### **Themelimi i marrëdhënies së punës**

#### **Neni 103**

- (1) Zgjedhja e kandidatit në thirrje është bazë për themelimin e marrëdhënies së punës në kohë të caktuar apo të pacaktuar. Marrëdhënia e punës bazohet në afatin për të cilën është zgjedhur personi, ndërsa kohëzgjatja definohet me kontratë përkatëse.

- (2) Gjatë pezullimit të marrëdhënies së punës, personi i zgjedhur ka të drejtë të ushtrojë veprimtari në arsimin e lartë në ciklin e parë, si dhe të jetë mentor në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve, pa kompensim financiar.
- (3) Personi i zgjedhur në një thirrje mësimore-shkencore, ose mësimore-profesionale dhe të cilit/të cilësi pezullohet marrëdhënia e tij/saj e punës, ka të drejtë të mbajë ligjërata dhe të jetë mentor i ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve, si dhe të kryejë aktivitete të tjera nga aktiviteti i arsimit të lartë.
- (4) Personit të zgjedhur në thirrje, mund t'i ndërpritet marrëdhënia e punës edhe para afatit për të cilën është zgjedhur, nëse vërtetohet se një kohë të gjatë nuk e realizon me sukses veprimtarinë arsimore - shkencore, nuk kontribuon në avancimin shkencor të të rinjve, nuk kujdeset në realizimin me sukses të programeve studimore, nuk kontribuon në zhvillimin e shkencës në të cilën është zgjedhur, pengon realizimin e aktiviteteve ligjore dhe statutoire të Universitetit, apo i pengon anëtarët e tjerë në realizimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre, si dhe në raste tjera të përcaktuara me ligj.
- (5) Procedura në lidhje me ndërprerjen e thirrjes dhe marrëdhënies së punës rregullohet me rregullore.

#### **E drejta për të ushtruar veprimtari në institucion tjetër të arsimit të lartë**

##### **Neni 104**

- (1) Personeli akademik nga një njësi universitare mund të kryejë veprimtari të arsimit të lartë në njësi tjetër universitare.
- (2) Personeli akademik nga Universiteti mund të kryejë veprimtari të arsimit të lartë në universitet tjetër në vend, me pëlqim të Rektorit të Universitetit pas mendimit paraprak të dekanit të fakultetit.

##### **Mësimdhënës vizitorë**

##### **Neni 105**

- (1) Me ftesë të Këshillit mësimor-shkencor të fakultetit, mësimdhënës nga institucionet e akredituara të arsimit të lartë, shkencëtarë të njohur nga vendi dhe jashtë vendit, si vizitorë pa shpallje të konkursit, mund të kryejnë veprimtari të arsimit të lartë dhe veprimtari hulumtuese-shkencore për kohë të caktuar.

- (2) Mësimdhënia nga mësimdhënësit vizitorë kryhet sipas sistemit modular, i cili mund të zgjasë së paku një javë.
- (3) Kushtet specifike në të cilat kryhet veprimtaria e mësimdhënësve vizitorë përcaktohet nga një kontratë e lidhur ndërmjet Universitetit dhe mësimdhënësve vizitorë.

### **Shkencëtarët, artistët dhe ekspertët e afirmuar nga praktika**

#### **Neni 106**

- (1) Shkencëtarët dhe ekspertët e afirmuar nga praktika, me ftesë të këshillit mësimor- shkencor, mund të japin mësim për pjesë të caktuara të lëndës.
- (2) Vëllimi dhe kushtet e angazhimit përcaktohen me kontratë të lidhur midis Universitetit dhe shkencëtarëve respektivisht ekspertëve të afirmuar nga praktika.

### **Thirrjet e titulluara**

#### **Neni 107**

- (1) Shkencëtarë dhe profesionistë të afirmuar nga praktika, të cilët i përmbushin kushtet për zgjedhje në thirrje, ndërsa për të cilët nuk ka vend të lirë për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore mund të zgjidhen në thirrjen docent titulluar, ose profesor inordinar i titulluar.
- (2) Personat e zgjedhur në thirrje akademike të titulluar mund të marrin pjesë në kryerjen e veprimtarisë së lartë arsimore më së shumti deri në 30% nga obligimet e rregullta në thirrjen adekuate mësimore-shkencore.
- (3) Llojin dhe vëllimin e pjesëmarrjes së personit të zgjedhur në thirrje të titulluar në kryerjen e veprimtarisë së lartë arsimore e përcakton Këshilli mësimor-shkencor.
- (4) Personat e zgjedhur në thirrje të titulluar nuk mund të jenë mentorë të punimeve të magjistraturës, ose doktoratës.
- (5) Nëse person i cili është zgjedhur në thirrje të titulluar docent ose profesor inordinar i titulluar, zgjidhet në thirrjet mësimoro-shkencore dhe themelon marrëdhënie pune në Universitet, zgjedhja në thirrje të titulluar i ndërpritet.
- (6) Personit i ndërpritet thirrja e titulluar docent, ose thirrja e titulluar profesor inordinar në fund në vitin shkollor në të cilin ka mbushur 67 vjet.

## **Profesor nderi dhe doktor shkence i nderit**

### **Neni 108**

- (1) Profesorit të shquar nga universitetet e vendit dhe nga jashtë, i cili ka dhënë kontribut të posaçëm për zhvillimin e veprimtarisë së arsimit të lartë, me propozim të njësisë, Universiteti mund t'i ndaj titullin profesor nderi (*profesor honoris causa*).
- (2) Personave të shquar shkencorë, kulturorë, afaristë dhe të tjerë nga vendi dhe nga jashtë, të cilët me veprat e veta kanë dhënë kontribut të posaçëm në zhvillimin e mendimit shkencor, kulturor, ose në mënyrë tjetër kanë kontribuar në zhvillimin e arsimit të lartë, me propozim të institucionit të lartë arsimor, përkatësisht institucionit të akredituar shkencor, Universiteti mund tu ndajë titullin doktor shkence i nderit (*doctor honoris causa*).

## **Profesor emeritus**

### **Neni 109**

- (1) Universiteti mundet, me propozim të Këshillit mësimor-shkencor të njësisë së caktuar t'i ndajë titull *Profesor emeritus* profesorit të rregullt në pension, i cili është shquar posaçërisht me punën e tij shkencore, përkatësisht artistike, i cili ka fituar reputacion ndërkombëtar dhe ka arritur rezultate në sigurimin e pasardhësve mësimorë-shkencorë dhe bashkëpunëtorë në sferën në të cilën është zgjedhur.
- (2) Numri i përgjithshëm i profesorëve emeritus nuk mund të jetë më shumë se 5 % e numrit të përgjithshëm të mësimdhënësve të Universitetit.
- (3) Profesori emeritus mund të marrë pjesë në realizimin e mësimimit në ciklin e dytë edhe të tretë të studimeve, në sferën në të cilën është zgjedhur.

## **Pushimi sabatik (*sabbatical*)**

### **Neni 110**

- (1) Personit të zgjedhur në thirrje mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe bashkëpunëtori me kërkesë të tij, çdo pesë vjet, Universiteti mund t'i lejojë pushim me pagesë në kohëzgjatje prej një viti, përkatësisht, pushim pa pagesë në kohëzgjatje deri tre vjet për shkak të

përsosjes profesionale, përkatësisht hulumtimit në sferën adekuate shkencore, ose për qëndrim në institucion adekuat, me ç'rast obligimet e tij në mësim shpërndahen.

- (2) Kushtet dhe mënyra e përdorimit pushimit sabbatik përcaktohen në detaje me rregullore të veçantë të Universitetit.

## **Diplomat**

### **Titulli profesional dhe shkencor**

#### **Neni 111**

- (1) Diplomat, titujt e specializuar dhe titujt shkencor përcaktohen në pajtim me ligjin, aktet e përgjithshme të Këshillit nacional për arsim të lartë dhe veprimtari shkencore-hulumtuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe aktet e përgjithshme të Universitetit.
- (2) Në Universitet fitohen llojet e mëposhtme të diplomave:
1. diploma për ciklin e parë të studimeve akademike (deridiplomike)- pas përfundimit të programit studimor tre ose katërvjeçar dhe pas fitimit të 180 gjegjësisht të 240 ECTS kredive;
  2. diploma për ciklin e dytë të studimeve akademike (pasdiplomike) - pas përfundimit të programit studimor një ose dy vjeçar dhe pas fitimit të 60 gjegjësisht të 120 ECTS kredive;
  3. diploma për ciklin e dytë të studimeve profesionale - pas përfundimit të programit studimor njëvjeçar dhe pas fitimit të 60 ECTS kredive,
  4. diplomë për thirrjen shkencore doktor i shkencave - pas përfundimit të programit studimor tre vjeçar dhe pas fitimit të 180 ECTS kredive.

## **XI. VETËVLERËSIMI**

#### **Neni 112**

- (1) Vetëvlerësimi i Universitetit dhe njësisive realizohet nga komisioni i vetëvlerësimit në intervale prej tre vjetësh.
- (2) Anëtarët e komisionit zgjidhen nga Senati i Universitetit, me mandat katërvjeçar, përkatësisht një vit për përfaqësuesit e studentëve.

- (3) Kushtet, organizimi dhe procedura e vetëvlerësimit më hollësisht rregullohen sipas standardeve evropiane ESG dhe rregullores së Universitetit.

## **XII BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR**

### **Neni 113**

- (1) Universiteti realizon bashkëpunim ndërkombëtar, i cili përfshin: pjesëmarrje në projekte, bashkëpunim me universitete, akademi nacionale dhe të tjera, bashkësi të biznesit, institute dhe qendra publike dhe private dhe subjekte të tjera me qëllim të përparimit të veprimtarisë së arsimit të lartë, veprimtarisë shkencore-hulumtuese dhe aplikative, këmbimit të publikimeve shkencore dhe profesionale, pjesëmarrjes në takime shkencore, simpoziume, konferenca, organizim të programeve studimore ndërkombëtare, organizimin e shkollave verore/dimërore, organizimin e studimeve jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut, mobilitet të studentëve dhe mësimdhënësve, pjesëmarrje në programe ndërkombëtare, asociacione etj.
- (2) Mbështetja institucionale për bashkëpunimin ndërkombëtar sigurohet nëpërmjet formimit të zyrave, qendrave dhe formave të tjera të organizimit në universitet.

## **XIII DOKUMENTACIONI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE**

### **Neni 114**

- (1) Nëpërmjet bazës së të dhënave, shërbimi profesional dhe administrativ i Universitetit është përgjegjës për mbajtjen e shënimeve të sakta për:
1. programet e akredituara;
  2. kandidatët e paraqitur për regjistrim në të tre ciklet e studimit për secilin afat të regjistrimit;
  3. studentët e regjistruar në të tre ciklet e studimit për secilin afat të regjistrimit;
  4. studentët që kanë përfunduar në të tre ciklet e studimit;
  5. mobilitetin e studentëve;
  6. stafit të punësuar me kontrata;

7. personat e zgjedhur në thirrje që janë në marrëdhënie pune;
8. personat e zgjedhur në thirrje që nuk janë në marrëdhënie pune;
9. mësimdhënësit vizitor;
10. profesionistët nga praktika;
11. profesorët emeritus;
12. punën shkencore dhe punën tjetër të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve;
13. projektet shkencore-hulumtuese;
14. projektet aplikative;
15. kohën e punës për të punësuarit;
16. mobilitetin e stafit;
17. veprimtarinë botuese;
18. marrëveshje të lidhura ndërkombëtare;
19. pronën e Universitetit;
20. llogaritë financiare;
21. kontratat komerciale; dhe
22. çështjet tjera relevante për funksionimin e Universitetit.

#### **Neni 115**

I gjithë stafi dhe studentët e Universitetit bashkëpunojnë me Sekretarin e përgjithshëm të Universitetit sa i takon dhënies së informatave që duhen ruajtur sipas evidencës nga neni paraprak.

#### **Neni 116**

Të gjitha të dhënat personale trajtohen me respekt ndaj privatësisë së tyre dhe përdoren vetëm për qëllime të caktuara me Ligj, ose me këtë Statut.



### **XIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 117**

- (1) Njësitë e Universitetit janë të obliguara që në afat prej gjashtë muajve të bëjnë, harmonizimin dhe plotësimin e akteve ekzistuese normative, si dhe miratimin e akteve normative që përcaktohen me këtë Statut.
- (2) Deri në sjelljen, harmonizimin dhe plotësimin e akteve nga al. 1 e këtij neni, do të zbatohen dispozitat e akteve ekzistuese.

#### **Neni 118**

Mandati i anëtarëve të Bordit, anëtarëve të Senatit dhe mandati i Rektorit të zgjedhur para hyrjes në fuqi të këtij Statuti vazhdon deri në skadimin e afatit për të cilin janë zgjedhur.

#### **Neni 119**

- (1) Brenda një viti pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti, Senati i Universitetit, do të zgjedhë një profesor ordinar si person i autorizuar për të pranuar fletëparaqitjet për korrupsion.

#### **Neni 120**

- (1) Studentët e regjistruar para hyrjes në fuqi të këtij Statuti vazhdojnë të studiojnë në bazë të rregullave që kanë qenë në fuqi në momentin e regjistrimit, përpos nëse dispozitat e reja nuk janë më të volitshme për ata.

#### **Neni 121**

- (1) Dispozitat e këtij Statuti që kanë të bëjnë me bashkëpunëtorët dhe demonstratorët do të zbatohen në përputhje me afatet ligjore.

#### **Neni 122**

- (1) Dispozitat e këtij Statuti që kanë të bëjnë me thirrjet mësimore-shkencore, do të zbatohen në përputhje me afatet ligjore.
- (2) Për personat që janë në marrëdhënie pune si docent dhe profesor inordinar, nuk do të zbatohet dispozita nga paragrafi 1, al. 1; paragrafi 2, al. 1; paragrafi 3, al.1, të nenit 166 të Ligjit për arsim të lartë.
- (3) Për personat e zgjedhur si lektor dhe lektor të lartë e që janë në marrëdhënie pune, nuk do të zbatohet dispozita nga paragrafi 1, al.3, paragrafi 2, al.3 nga neni 168, të Ligjit për arsim të lartë.

### **Neni 123**

Mandati i përfaqësuesve të studentëve në organet dhe trupat e Universitetit dhe fakultetit vazhdon deri në zgjedhjen e përfaqësuesve nga ana e Parlamentit Studentor të Universitetit, por, jo më gjatë se afati i paraparë me Ligjin për arsim të lartë.

### **Neni 124**

Ky Statut hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në ueb faqen dhe buletin e Universitetit. Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij Statuti, shfuqizohen dispozitat e Statutit të Universitetit nga viti 2008, me numër arkivi 01-4655/1, nga 11.12.2008.

KRYETARI I BORDIT TË UEJL-së